FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 41	**2000**	**Dhjetor**

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr.8695 datë 23.11.2000	Për ratifikimin e "Marrëveshjes për konsolidimin e borxhit të jashtëm të Shqipërisë, në bazë të termave të referencës së Klubit të Parisit, të tetorit 1999, ndërmjet qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Italiane"	1863
Ligj nr.8699 datë 23.11.2000	Për ratifikimin e Konventës-Kuadër Europiane "Për bashkëpunimin ndërkufitar të bashkësive vendore e të autoriteteve territoriale dhe të dy protokolleve shtesë të saj".....	1873
Vendim i KM nr.641, datë 30.11.2000	Për një shtesë në vendimin nr.335, datë 2.9.1997, "Për pajisjen me pasaportë shërbimi dhe diplomatike".....	1901
Vendim i KM nr.645, datë 5.12.2000	Për një ndryshim në vendimin nr.531, datë 5.10.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotën e pranimit në Akademinë e Policisë, në vitin shkollor 2000-2001, në sistemin me shkëputje nga puna".....	1901
Vendim i KM nr.652, datë 5.12.2000	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.224, datë 15.5.1995, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Këshillit Konsultativ të Aviacionit Civil".....	1903

L I G J
Nr.8695, datë 23.11.2000

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES PËR KONSOLIDIMIN E BORXHIT TË JASHTËM TË SHQIPËRISË, NË BAZË TË TERMAVE TË REFERENCËS SË KLUBIT TË PARISIT, TË TETORIT 1999, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja për konsolidimin e borxhit të jashtëm të Shqipërisë, në bazë të termave të referencës së Klubit të Parisit, të tetorit 1999, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2820, datë 5.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË ITALISË LIDHUR ME KONSOLIDIMIN E BORXHIT TË JASHTËM TË SHQIPËRISË

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Italisë, në frymën e miqësisë dhe bashkëpunimit ekonomik që ekziston ndërmjet dy vendeve dhe në zbatim të Termave të Referencës së Klubit të Parisit të datës 14 Tetor 1999 për ristrukturimin e borxhit të jashtëm të Shqipërisë, kanë vendosur sa më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i kësaj marrëveshjeje është shtyrja:

a) e borxheve, për kapitale e interesa, me skadencë nga 1 Prilli 1999 deri në 30 Qershor 2000 përfshirë, dhe të parregulluara, të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë ndaj Institutit të Shërbimeve të Sigurimit të Tregtisë (më poshtë quajtur SACE) dhe ato që lidhen me nenin I të marrëveshjes për konsolidimin midis Qeverisë së Republikës të Shqipërisë përfunduar në 9 Shtator 1994 në zbatim të Termave të Referencës të datës 15 Dhjetor 1993.

b) e borxheve, për kapitale e interesa, që skadon në datën 1 Prill 1999 deri në 30 Qershor 2000 përfshirë, dhe të parregulluara, të Qeverisë së Republikës ë Shqipërisë për SACE dhe ato që lidhen me Nenin 1 të marrëveshjes për konsolidimin midis Qeverisë Italiane dhe Qeverisë së

Republikës së Shqipërisë përfunduar më 12.10.2000 në zbatim të Termave të Referencës të datës 22 Korrik 1998.

c) e borxheve, për kapitale dhe interesa, të detyruara në 31 Mars 1999 dhe të parregulluara, të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë ose të sektorit të saj publik ose të garantuara nga ajo, duke iu referuar veprimeve tregtare me afat për më shumë se një vit, përcaktuar në kontratat ose marrëveshjet financiare të nënshkruara përpara 30 shtatorit 1993, ndihmuar nga garancia siguruese e shtetit Italian nëpërmjet SACE-s.

d) e interesave në afate të vonuara për borxhet e përmendura në paragrafin c) të llogaritura nga data e skadencës së secilës deri në 31 Mars 1999 për taksat e interesave të treguara në Nenin 3 vijues.

e) e borxheve, për kapitale e interesa, për datën 31 Mars 1999 dhe të parregulluara të lidhura në kontrata dhe marrëveshje financiare të firmosura para 1 Prillit 1999 me skadencë origjinë brenda 1 viti.

f) e interesave të vonuara për borxhet e përmendura në paragrafin e) të llogaritura nga data e skadencës së secilës deri në 31 Mars 1999 për përqindjen e interesave të përmendura në nenin III vijues.

g) e borxheve, për kapitale dhe interesa, me skadencë nga 1 Prilli 1999 deri në 30 Qershor 2000 përfshirë, dhe të parregulluara, që lidhen me marrëveshjet financiare midis Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Mediocredito Centrale, të firmosura brenda 30 Shtatorit 1993.

h) e borxheve, për kapitale dhe interesa, me skadencë nga 1 Prill 1999 deri në 30 Qershor 2000 përfshirë, dhe të parregulluara, lidhur me marrëveshjet financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Mediocredito Centrale, të firmosura brenda 30 Shtatorit 1993 deri në 1 Prill 1999.

i) e interesave të maturuara nga 1 Prilli 1999 deri në 30 Qershor 2000 përfshirë, të kapitalizuara deri më 30 Qershor 2000, për borxhet përkatësisht përmendur në pikat a), b), c), d), e), f).

j) e interesave të maturuara nga 1 Prilli 1999 deri në 30 Qershor 2000 përfshirë, të kapitalizuara deri në 30 Qershor 2000, për borxhet përkatësisht të përmendura në pikat g), h).

Borxhet në fjalë janë të listuara në dokumentet bashkëngjitur kësaj marrëveshjeje të përbashkët midis palëve kontraktore.

Neni 2

Borxhet e përmendura në nenin 1, do të rimbursohen dhe kthehen në valutën e përcaktuar në kontrata ose në marrëveshjet financiare përkatëse nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë (më poshtë quajtur Qeveria) tek SACE dhe Mediocredito Centrale mesatarisht në 10 këste gjashtëmujore, të barabartë dhe të njëpasnjëshëm, me skadencë të parë në 30 Qershor 2001 dhe e fundit në 31 Dhjetor 2005.

Neni 3

Mbi shumën e përgjithshme të borxheve të shtyra, përmendur në nenin 1 paragrafi a), b),c),d), e), f) dhe i) Qeveria merr përsipër t'i paguajë dhe t'i kthejë SACE-s interesa për periudhën midis skadencës së secilit borxh deri në shlyerjen totale të këtyre borxheve të llogaritura me përqindjen e interesave Libor 6 mujor plus 0.5% për borxhet në lireta dhe DM (tani Euro).

Mbi shumën e përgjithshme të borxheve të shtyra, përmendur në nenin 1 paragrafi g), h) dhe l) Qeveria duhet t'i paguajë dhe t'i kthejë Mediocredito Centrale-s interesa për periudhën midis skadencës të secilit borxh deri në shlyerjen totale të vetë borxheve, të llogaritura me përqindjet e interesave të përcaktuara në marrëveshjet përkatëse të huasë.

Interesat sa më sipër do të rregullohen në valutën e caktuar në kontrata ose vendime financiare në këste 6 mujore (30 qershor - 31 dhjetor), ku e para do të skadojë në 31 Dhjetor 2000.

Neni 4

Për një vonesë të mundshme, në më shumë se 30 ditë, në pagesat që përmendëm në nenet 2 dhe 3 përkatësisht në datat e parashikuara, Qeveria merr përsipër t'i paguajë me përpikëri SACE-s dhe Mediocredito Centrale-s interesat e vonesave të llogaritura sa më poshtë:

a) për kreditë e SACE-s në dollarë amerikanë, në bazë të Libor të kuotuar për 6 muaj në datën e skadencës së borxhit plus 1% në vit.

b) Për kreditë e SACE-s në lireta dhe DM (tani Euro), në bazë të Euribor të kuotuara për 6 muaj në datën e skadencës plus 1 % në vit.

c) Për kreditë e Mediocredito Centrale me përqindje interesi prej 5 %.

Neni 5

Me përjashtim për sa është parashikuar në këtë marrëveshje, mbeten të pagjykuara lidhjet juridike të përcaktuara nga e drejta e përbashkët dhe detyrimet kontraktore të ndërmarra nga palët për veprimet që lidhen me borxhet e përmendura në nenin I të kësaj marrëveshjeje.

Neni 6

Kjo marrëveshje hyn në fuqi datën e marrjes së njoftimit të fundit në të cilin të dy palët do të njoftojnë zyrtarisht mbylljen e procedurave të brendshme të parashikuara nga rregulloret përkatëse.

Në mirëbesim, përfaqësuesit nënshkrues të autorizuar firmosën rregullisht këtë marrëveshje.

Kryer në Tiranë, më 12.10.2000 në dy kopje origjinale në gjuhën italiane dhe shqipe dhe të dyja me të njëjtën fuqi ligjore.

PËR QEVERINË
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË
E REPUBLIKËS ITALIANE

SHQIPËRIA
TERMAT E REFERENCËS SË 14.10.1999

BORXHET E LIDHURA ME ART.I PARAGRAFI e)

SACE
Data e përpunimit:30.08.2000
LISTA E KËSTEVE SIPAS MARRËVESHJEVE TË MËPARSHME
Kodi i shtetit: 87 Shqipëri
Kodi i Marrëveshjes:ALB A3
Prog.Lista:3
Monedha:69$ USD

RISTRUKTURIMI I KËSTEVE NGA:1.4.1999-30.6.2000
MARRËVESHJA SHUMËPALËSHE: 14.10.1999

MARRËVESHJA DYPALËSHE

Marrëveshja	Dt.nënshkrimit	Pr.Lista	Dt.Skadencës	Shuma	Shuma e ristrukturuar
ALB A1	9/9/94	1 1	31.12.1999 30/06/2000	177.065,37 202.646,66 379.712,03	177.065,37 202.646,66 379.712,03
			Totali	379.712,03	379.712,03

SACE
Data e përpunimit:01.09.2000 KTHIMI I BORXHEVE
Kodi i shtetit: 87 Shqipëri
Kodi i Marrëveshjes:ALB A3
Prog.Lista:1
Monedha:69 USD
RISTRUKTURIMI I KËSTEVE NGA:1.4.1999-30.6.2000
MARRËVESHJA SHUMËPALËSHE: 14.10.1999

MARRËVESHJA DYPALËSHE

RISTRUKTURIMI I KËSTIT 100% E PRINCIPALIT DHE 100% E INTERESIT
6.63 1250

SACE
Data e përpunimit:01.09.2000 KTHIMI I BORXHEVE
Kodi i shtetit: 87 Shqipëri
Kodi i Marrëveshjes:ALB A3
Prog.Lista:1
Monedha:69$ USD

RISTRUKTURIMI I KËSTEVE NGA: MARRËVESHJET E MËPARSHME 1.4.1999-30.6.2000
MARRËVESHJA SHUMËPALËSHE: 14.10.1999
KËSTI I RISTRUKTURAVE: $ USA 379,712.03 lidhur me 100% principal dhe 100% interes

MARRËVESHJA DYPALËSHE

Data	%	PRINCIPALI	INTERESI	GJITHSEJ KËSTI
30.06.2000	100. 00000	379,712.03	5.936.06	385,648.09
	GJITHSEJ	379,712.03	5.936.06	385,648.09

SACE
Data e përpunimit: 30.08.2000 LISTA E KËSTEVE SIPAS MARRËVESHJEVE TË MËPARSHME
Kodi i shtetit: 87 Shqipëri
Kodi i Marrëveshjes:ALB A3
Prog.Lista:2
Monedha: 86 Lit
RISTRUKTURIMI I KËSTEVE NGA:1/O4.1999-30/06/2000
MARRËVESHJA SHUMËPALËSHE:14/10/1999

MARRËVESHJA DYPALËSHE

Marrëveshja	Dt.nënshkrimit	Pr.Lista	Dt.Skadencës	Shuma	Shuma e ristrukturuar
ALB A1	9.9.94	2 2	31.12.1999 30.06.2000	203.192.531,00 228.415.533,00 431.608.064,00	203.192.531,00 228.415.533,00 431.608.064,00
			Totali	431.608.064,00	431.608.064,00

SACE
Data e përpunimit:01.09.2000 KTHIMI I BORXHEVE
Kodi i shtetit: 87 Shqipëri
Kodi i Marrëveshjes:ALB A3
Prog.Lista:2
Monedha:86 LIT

RISTRUKTURIMI I KËSTEVE NGA:MARRËVESHJET E MËPARSHME 1.4.1999-30.6.2000
MARRËVESHJA SHUMËPALËSHE: 14.10.1999

MARRËVESHJA DYPALËSHE

RISTRUKTURIMI I KËSTIT 100% E PRINCIPALIT DHE 100% E INTERESIT
4.017500

SACE
Data e përpunimit:01.09.2000 KTHIMI I BORXHEVE
Kodi i shtetit: 87 Shqipëri
Kodi i Marrëveshjes:ALB A3
Prog.Lista:2
Monedha:86$ USD
RISTRUKTURIMI I KËSTEVE NGA:1.4.1999-30.6.2000
MARRËVESHJA SHUMËPALËSHE: 14.10.1999
KËSTI I RISTRUKTURUAR: 431,698,064.00 lidhur me 100% principal dhe 100% interes

MARRËVESHJA DYPALËSHE

Data	%	PRINCIPALI	INTERESI	GJITHSEJ KËSTI
30.06.2000	100. 00000	431,608,064.00	4,126,985.00	435,735,049.00
	GJITHSEJ	431,608,064.00	4,126,985.00	435,735,049.00

BORXHET E LIDHURA ME ART. I PARAGRFAFI b)

SACE
Data e përpunimit: 30.08.2000 LISTA E KËSTEVE SIPAS MARRËVESHJEVE TË MËPARSHME
Kodi i shtetit: 87 Shqipëri
Kodi i Marrëveshjes:ALB A3
Prog.Lista:5
Monedha: 69 USD

RISTRUKTURIMI I KËSTEVE TË MARRËVESHJEVE TË MËPARSHME NGA: 1.4.1999-30.6.2000
MARRËVESHJA SHUMËPALËSHE: 14.10.1999

MARRËVESHJA DYPALËSHE

Marrëveshja	Data Bilat.	Pr.Lista	Dt.Skadencës	Kësti	Kësti i ristrukturuar
ALB A2		1	01.05.2000	73,695.75 73,695.75	73,695.75 73,695.75
			Gjithsej:	73,695.75	73,695.75

SACE
Data e përpunimit:04.09.2000 KTHIMI I BORXHEVE
Kodi i shtetit: 87 Shqipëri
Kodi i Marrëveshjes:ALB A3
Prog.Lista:5
Monedha:69 USD

RISTRUKTURIMI I KËSTEVE NGA MARRËVESHJET E MËPARSHME 1.4.1999-30.6.2000
MARRËVESHJA SHUMËPALËSHE: 14.10.1999

MARRËVESHJA DYPALËSHE

RISTRUKTURIMI I KËSTIT 100% E PRINCIPALIT DHE 100% E INTERESIT
7.231 250

SACE
Data e përpunimit:01.09.2000 KTHIMI I BORXHEVE
Kodi i shtetit: 87 Shqipëri
Kodi i Marrëveshjes:ALB A3
Prog.Lista:5
Monedha:69$ USD

RISTRUKTURIMI I KËSTEVE NGA MARRËVESHJET E MËPARSHME1.4.1999-30.6.2000
MARRËVESHJA SHUMËPALËSHE: 14.10.1999
KËSTI I RISTRUKTURUAR: $ USA 73,695,75.00 lidhur me 100% principal dhe 100% interes

MARRËVESHJA DYPALËSHE

Data	%	PRINCIPALI	INTERESI	GJITHSEJ KËSTI
30.06.2000	100 00000	73,695.75	888.19	74,583.94
	GJITHSEJ	73,695.75	888.19	74,583.94

SACE
Data e përpunimit: 30.08.2000 LISTA E KËSTEVE SIPAS MARRËVESHJEVE TË MËPARSHME
Kodi i shtetit: 87 Shqipëri
Kodi i Marrëveshjes:ALB A3
Prog.Lista:6
Monedha: 86 LIT

RISTRUKTURIMI I KËSTEVE TË MARRËVESHJEVE TË MËPARSHME NGA: 1.4.1999-30.6.2000
MARRËVESHJA SHUMËPALËSHE: 14.10.1999

MARRËVESHJA DYPALËSHE

Marrëveshja	Data Bilat	Pr.Lista	Dt.Skadencës	Kësti	Kësti i ristrukturuar
ALB A2		2	01.05.2000	160,409,243.00 160,409,243.00	160,409,243.00 160,409,243.00
			GJITHSEJ:	160,409,243.00	160,409,243.00

SACE
Data e përpunimit:04.09.2000 KTHIMI I BORXHEVE
Kodi i shtetit: 87 Shqipëri
Kodi i Marrëveshjes:ALB A3
Prog.Lista:6
Monedha:86 lit

RISTRUKTURIMI I KËSTEVE NGA MARRËVESHJET E MËPARSHME 1.4.1999-30.6.2000
MARRËVESHJA SHUMËPALËSHE: 14.10.1999

MARRËVESHJA DYPALËSHE

RISTRUKTURIMI I KËSTIT 100% E PRINCIPALIT DHE 100% E INTERESIT
4.763750

SACE
Data e përpunimit:01.09.2000 KTHIMI I BORXHEVE
Kodi i shtetit: 87 Shqipëri

Kodi i Marrëveshjes:ALB A3
Prog.Lista:5
Monedha:86 LIT

RISTRUKTURIMI I KËSTEVE NGA MARRËVESHJET E MËPARSHME 1.4.1999-30.6.2000
MARRËVESHJA SHUMËPALËSHE: 14.10.1999
KËSTI I RISTRUKTURUAR: 160,409,243.00 LIDHUR ME 100% PRINCIPAL DHE 100% INTERES

MARRËVESHJA DYPALËSHE

Data	%	PRINCIPALI	INTERESI	GJITHSEJ KËSTI
30.06.2000	100 00000	160,409,243.00	1,273,584.00	161,682,827.00
	GJITHSEJ	160,409,243.00	1,273,584.00	161,682,827.00

BORXHET E LIDHURA ME ART. I PARAGRAFI c)
SACE
Data e përpunimit: 01.09.2000 PËRMBLEDHËSE PËR POLICAT
Kodi i shtetit: 87 Shqipëri
Kodi i Marrëveshjes:ALB A3
Prog.Lista:4
Monedha: 86 LIT

RISTRUKTURIMI I KËSTEVE NGA: DERI:31.03.1999
MARRËVESHJA SHUMËPALËSHE: 14.10.1999

MARRËVESHJA DYPALËSHE

Numri i polices	I siguruari	Debitori	Skadenca	Kësti	Kësti i ristrukturuar
91 000257 00	Simod S.P.A.	Ndërmarrja e Gomës	30.06.1998	624,978.541,00 624,978.541,00	624,978.541,00 624,978.541,00
			Totali	624,978.541,00	624,978.541,00

SACE
Data e përpunimit:01.09.2000 KTHIMI I BORXHEVE
Kodi i shtetit: 87 Shqipëri
Kodi i Marrëveshjes:ALB A3
Prog.Lista:4
Monedha:86 lit

RISTRUKTURIMI I KËSTEVE NGA DERI MË: 31.03.1999
MARRËVESHJA SHUMËPALËSHE: 14.10.1999

MARRËVESHJA DYPALËSHE

RISTRUKTURIMI I KËSTIT 100% E PRINCIPALIT DHE 100% E INTERESIT
5.312500 30.12.1998 – 3.72 1090 31.12.1998 29.6.1999 – 3.324380 30.6.1999 30.12.1999 4.017500 30.12.1999

SACE
Data e përpunimit:01.09.2000 KTHIMI I BORXHEVE
Kodi i shtetit: 87 Shqipëri
Kodi i Marrëveshjes:ALB A3
Prog.Lista:4
Monedha:86 lit

RISTRUKTURIMI I KËSTEVE NGA: DERI MË 31.03.1999
MARRËVESHJA SHUMËPALËSHE: 14.10.1999 MARRËVESHJA DYPALËSHE
KËSTI I RISTRUKTURUAR: LIT 624,978,541.00 Lidhur me 100% principal dhe 100% Interes
INTERESA ME:31.03.1999 – LIT 22,756,279.00 TË KAPITALIZUAR

PROGR.	DATA	PRINCIPALI	INTERESI	GJITHSEJ	PRINCIPALI QË NGELET
1	30.06.2000	647,734,820.00	30,259,769.00	677,994,589.00	647,734,820.00
	GJITHSEJ 647,734,820.00		30,259,769.00	677,994,589.00	

*) Interes-vonesat llogaritur deri më 31.03.1999 (Neni I, Paragrafi d)
BORXHET E LIDHURA ME ART.I PARAGRAFI e)

SACE
Data e përpunimit: 01.09.2000 KTHIMI I BORXHEVE
Kodi i shtetit: 87 Shqipëri
Kodi i Marrëveshjes:ALB A3
Prog.Lista:3
Monedha: 94 DM
RISTRUKTURIMI I KËSTEVE NGA: DERI 31/03/1999
MARRËVESHJA SHUMËPALËSHE: 14.10.1999
MARRËVESHJA DYPALËSHE

Numri i polices	I siguruari	Debitori	Skadenca	Kësti	Kësti i ristrukturuar
90 001949 00	Banka Komerciale Italiane	Banka e Shtetit	30.08.1991 30.08.1991	209,84 9.114,80 9.324,64	209,84 9.114,80 9.324,64
			GJITHSEJ:	9.324,64	9.324,64

SACE
Data e përpunimit:01.09.2000 KTHIMI I BORXHEVE
Kodi i shtetit: 87 Shqipëri

Kodi i Marrëveshjes:ALB A3
Prog.Lista:3
Monedha:94 DM

RISTRUKTURIMI I KËSTEVE NGA: Deri më 31.3.1999
MARRËVESHJA SHUMËPALËSHE: 14.10.1999

MARRËVESHJA DYPALËSHE

RISTRUKTURIMI I KËSTIT 100% E PRINCIPALIT DHE 100% E INTERESIT
9.937500 28.02.1992-10.125000 29.02.1992 29.08.1992-10.375000 30.08.1992 27.02.1993
8.375000 28.02.1993 29.08.1993-6.937500 30.08.1993 27.02.1994-6.250000 28.02.1994
29.08.1994
5.562500 30.08.1994 27.02.1995-5.812500 28.02.1995 29.08.1995-4.812500 30.08.1995
28.02.1996
4.125000 29.02.1996 29.08.1996-3.687500 30.08.1996 27.02.1997-3.656200 28.02;1997
29.08.1997
3.968700 30.08.1997 27.02.1998-4.125000 28.02.1998 29.08.1998-4.093750 30.08.1998
27.02.1999
3.556250 28.02.1999 29.08.1999-3.570000 30.08.1999 28.02.2000-4.320000 29.02.2000

SACE
Data e përpunimit: 30.08.2000 LISTA E KËSTEVE SIPAS MARRËVESHJEVE TË MËPARSHME
Kodi i shtetit: 87 Shqipëri
Kodi i Marrëveshjes:ALB A3
Prog.Lista:3
Monedha: 94 DM

RISTRUKTURIMI I KËSTEVE NGA:
MARRËVESHJA SHUMËPALËSHE:14.10.1999 MARRËVESHJA DYPALËSHE
KËSTI I RISTRUKTURUAR:DM 9.324.64 LIDHUR ME 100% PRINCIPAL DHE 100% INTERES
INTERESA ME: 31.03.1999 – DM – 4,371.31 TË KAPITALIZUAR

PROGR.	DATA	PRINCIPALI	INTERESI	GJITHSEJ	PRINCIPALI QË NGELET
1	30.06.2000	13,695.95	654.99	14.350.94	13,695.95
	GJITHSEJ	13,695.95	654.99	14.350.94	

L I G J
Nr.8699, datë 23.11.2000

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS-KUADËR EUROPIANE "PËR BASHKËPUNIMIN NDËRKUFITAR TË BASHKËSIVE VENDORE E TË AUTORITETEVE TERRITORIALE DHE TË DY PROTOKOLLEVE SHTESË TË SAJ"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet Konventa-Kuadër Europiane "Për bashkëpunimin ndërkufitar të bashkësive vendore e të autoriteteve territoriale dhe të dy protokolleve shtesë të saj".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2824, datë 5.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

KONVENTA
KUADËR EUROPIANE PËR BASHKËPUNIMIN
NDËRKUFITAR TË BASHKËSIVE VENDORE OSE
AUTORITETEVE TERRITORIALE

H Y R J E

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, nënshkruese të kësaj Konvente,

Duke konsideruar që synimi i Këshillit të Europës është të realizojë një bashkëpunim më të ngushtë midis anëtarëve të vet dhe të promovojë bashkëpunimin ndërmjet tyre;

Duke konsideruar se sipas nenit 1 të statusit të Këshillit të Europës ky synim do të realizohet veçanërisht nga lidhja e marrëveshjeve në fushën administrative;

Duke konsideruar se Këshilli i Europës synon të sigurojë pjesëmarrjen e njësive vendore ose autoriteteve territoriale të Europës në realizimin e qëllimit të vet;

Duke konsideruar rëndësinë që mund të marrë në ndjekjen e këtij objektivi bashkëpunimi i njësive vendore ose autoriteteve territoriale kufitare në fusha të tilla si zhvillimi rajonal, urban dhe rural, mbrojtja e mjedisit, përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve ndaj qytetarëve dhe ndihma e ndërsjelltë në rast katastrofe;

Duke vlerësuar sipas eksperiencës së fituar, se bashkëpunimi i pushtetit vendor dhe rajonal të Europës mund të lejojë zbatimin më të mirë të misionit të tyre, dhe veçanërisht mund të kontribuojë në vlerësimin dhe zhvillimin e rajoneve kufitare;

Të vendosur për të favorizuar sa të jetë e mundur këtë bashkëpunim dhe për të kontribuar kështu në progresin ekonomik dhe social të rajoneve kufitare dhe në solidaritetin që bashkon popujt e Europës,

Vendosën si më poshtë:

Neni 1

Çdo palë kontraktuese angazhohet të lehtësojë dhe të nxisë bashkëpunimin ndërkufitar ndërmjet bashkësive ose autoriteteve territoriale që janë nën juridiksionin e saj dhe bashkësive ose autoriteteve territoriale që janë në kompetencë të palëve të tjera kontraktuese.

Ajo do të përpiqet të promovojë lidhjen e marrëveshjeve dhe rregullimeve të nevojshme për këtë qëllim, duke respektuar dispozitat kushtetuese të secilës palë.

Neni 2

1. Konsiderohet si bashkëpunim ndërkufitar sipas kësaj Konvente çdo mirëkuptim që synon të forcojë e të zhvillojë rosertet e fqinjësisë ndërmjet bashkësive ose autoriteteve territoriale që varen nga dy ose shumë palë kontraktuese, si dhe lidhja e marrëveshjeve dhe aranxhimet e nevojshme për këtë qëllim. Bashkëpunimi ndërkufitar do të ushtrohet në kuadrin e kompetencave të bashkësive ose autoriteteve territoriale, ashtu siç janë përcaktuar nga (e drejta) e brendshme. Shtrirja dhe lloji i këtyre kompetencave nuk janë përcaktuar nga kjo Konventë.

2. Sipas qëllimeve të kësaj Konvente, shprehja "bashkësi a autoritete territoriale", nënkupton bashkësi, autoritete ose organizma që ushtrojnë funksione vendore dhe rajonale dhe konsiderohen si të tilla në kompetencën e brendshme të çdo shteti. Megjithatë, çdo Palë kontraktuese mundet, në momentin e nënshkrimit të kësaj Konvente ose nëpërmjet rrugës së komunikimit të mëvonshëm me Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të zgjedhë bashkësitë, autoritetet e organizmat, objektet dhe format me të cilat ajo mendon të kufizojë fushën e zbatimit ose që ajo mendon të përjashtojë nga fusha e zbatimit të kësaj Konvente.

Neni 3

Sipas qëllimit të kësaj Konvente, Palët kontraktuese favorizojnë, nën rezervën e dispozitave të nenit 2, paragrafi 2, nismat e bashkësive dhe autoriteteve territoriale, duke marrë në konsideratë skemat e aranxhimeve ndërmjet bashkësive dhe autoriteteve territoriale të përpunuara në kuadrin e Këshillit të Europës. Nëse e vlerësojnë të nevojshme, ato mund të marrin në konsideratë modelet e marrëveshjeve ndërshtetërore, dypalëshe a shumëpalëshe rregulluar në Këshillin e Europës dhe të destinuara për të lehtësuar bashkëpunimin ndërmjet bashkësive dhe autoriteteve territoriale.

1. Aranxhimet dhe marrëveshjet që do të përfundohen mund të nxiten veçanërisht nga modelet dhe skemat e marrëveshjeve nga statuset dhe kontratat shtojcë të kësaj Konvente duke filluar nga 1.1 deri më 1.5 dhe nga 2.1 deri më 2.6 me kusht që t'u bëhen adaptimet e nevojshme të diktuara nga situata e veçantë e çdo Palë kontraktuese. Këto modele dhe skema marrëveshjesh, statutesh dhe kontratash, duke qënë të natyrës indikative, nuk kanë vlerë konvencionale.

2. Në rastin kur Palët kontaktuese vlerësojnë të nevojshme dhe përfundimin e marrëveshjes ndërshtetërore, këto të fundit mund të fiksojnë veçanërisht kuadrin, format dhe limitet në të cilat mund të veprojnë bashkësitë dhe autoritetet territoriale të përfshira në bashkëpunimin ndërkufitar. Çdo marrëveshje mund të përcaktojë gjithashtu bashkësitë ose organizmat në të cilat ajo aplikohet.

3. Dispozitat e mëparshme nuk i lejojnë të drejtën Palëve kontraktuese për të kaluar nga një marrëveshje e përbashët në forma të tjera bashkëpunimi ndërkufitar. Gjithashtu, dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të interpretohen sikur i çvlerësojnë marrëveshjet e bashkëpunimit tashmë ekzistuese.

4. Marrëveshjet dhe aranxhimet do të përfundohen duke respektuar kompetencat e parashikuara nga e drejta e brendshme e çdo Pale kontraktuese në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të orientimit të politikës së përgjithshme, si dhe duke respektuar rregullat e kontrollit ose tutelës, të cilave i nënshtrohen bashkësitë ose autoritetet territoriale.

5. Për këtë arsye, çdo Palë kontraktuese mundet, në momentin e nënshkrimit të kësaj Konvente ose nëpërmjet rrugës së komunikimit të mëvonshëm me Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të përcaktojë autoritetet që sipas së drejtës së vet të brendshme, janë kompetente për të ushtruar kontrollin a tutelën ndaj bashkësive dhe autoriteteve territoriale përkatëse.

Çdo Palë kontraktuese do të përpiqet të zgjidhë vështirësitë e rendit juridik, administrativ dhe teknik që mund të nxjerrin pengesa në zhvillimin e funksionimin e mirë të bashkëpunimit ndërkufitar dhe do të këshillohet sa të jetë e nevojshme me Palët e tjera kontraktuese të interesuara.

Neni 5

Në rastin e një bashkëpunimi ndërkufitar të ndërmarrë konform dispizitave të kësaj Konvente, Palët kontraktuese do të shikojnë oportunitetin për t'i akorduar bashkësive ose autoriteteve territoriale pjesëmarrëse të njëjtat lehtësi si në rastin kur bashkëpunimi do të ushtrohet në planin e brendshëm.

Neni 6

Çdo Palë kontraktuese do të japë sa të jetë e mundur, informacionet që i kërkohen nga një Palë tjetër kontaktuese ,me qëllim që të lehtësojë vënien në jetë nga kjo e fundit të detyrimeve që i dalin sipas kësaj Konvente.

Neni 7

Çdo Palë kontraktuese do të kujdeset që bashkësitë ose autoritetet territoriale përkatëse të jenë të informuara për mënyrat e veprimit që i ofrohen nga kjo Konventë.

H.J.Ordemann
Për Qeverinë e Republikës Hellenike
Për Qeverinë e Republikës Islandeze
Për Qeverinë e Irlandës
Sylvester Barret
Për Qeverinë e Republikës Italiane
Marino Corder
Për Qeverinë e Principatës së Lishtenstejnit
Strasbourg, më 20 Tetor 1983
Nicolas, Princi i Lishtenstejnit
Për Qeverinë e Luksemburgut
Jean Spautz
Për Qeverinë e Hollandës
I.Van E.Tengbergen
Për Qeverinë e Mbretërisë së Norvegjisë
Inger Louise Valle
Për Qeverinë e Republikës Portugeze
Luis Octavio Roma da Albuquerque
Për Qeverinë e Republikës së San Marinos
Për Qeverinë e Mbretërisë së Spanjës
Strasbourg, më 1 Tetor 1986
Fernando Baeza
Për Qeverinë e Mbretërisë së Suedisë
Për Qeverinë e Konfederatës Zviceriane
Strasbourg, më 16 Prill 1981
Për Qeverinë e Republikës Turke

Për Qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar të Anglisë dhe Irlandës së Veriut,

Neni 8

1. Palët kontraktuese do t'i transmetojnë Sekretarit të Përgjithshëm çdo informacion të duhur lidhur me marrëveshjet dhe aranxhimet e shënuara në nenin 3.

2. Çdo propozim i bërë nga një a më shumë Palë kontraktuese me qëllim që të plotësohet a hartohet Konventa ose modelet e marrëveshjeve dhe aranxhimeve do t'i transmetohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Ky i fundit do t'ia përcjellë atë Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës që do të vendosë për vazhdimësinë.

Neni 9

1. Kjo Konventë është e hapur për t'u firmosur nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës. Ajo do të ratifikohet, pranohet dhe miratohet. Instrumentet e ratifikuara, të pranimit ose të miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Konventa do të hyjë në fuqi tre muaj pas depozitimit të instrumentit të katërt të ratifikimit, të pranimit ose të miratimit, me kusht që jo më pak se dy nga shtetet që kanë plotësuar këtë formalitet, të kenë një kufi të përbashkët.

3. Ajo do të hyjë në fuqi përçdo shtet nënshkrues që do ta ratifikojë, pranojë a miratojë atë më vonë, tre muaj pas datës të depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, të pranimit a të miratimit.

Neni 10

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave mund të vendos në unanimitet të votave të paraqitura, që do të ftojë çdo shtet europian jo anëtar që të aderojë në këtë Konventë. Kjo ftesë duhet të marrë pëlqimin e duhur nga çdo shtet që ka ratifikuar Konventën.

2. Aderimi do të kryhet nëpërmjet depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës të një të një instrumenti aderimi që do të hyjë në veprim tre muaj pas datës së depozitimit të tij.

Neni 11

1. Çdo Palë kontraktuese mund, për sa i takon, të denoncojë këtë Konventë duke i drejtuar një njoftim Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Denoncimi do të ketë efekt gjashtë muaj pas datës së pranimit të njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 12

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'i njoftojë shteteve anëtare të Këshillit dhe çdo shteti që ka aderuar në këtë Konventë:

a) çdo firmosje,

b) depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit, miratimit a aderimit,

c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, konform nenit të saj nr.9,

d) çdo deklaratë të marrë në zbatim të dispozitave të paragrafit 2 të nenit 2 a të paragrafit 5 të nenit 3.

e) Çdo njoftim i marrë në zbatim të dispozitave të nenit 11 dhe datën kur denoncimi do të marrë zbatim.

Nënshkruesit, të autorizuar për këtë veprim, kanë nënshkruar Konventën në fjalë.

Hartuar në Madrid më 21 Maj 1980, në frëngjisht dhe anglisht, një kopje e vetme e besuar e të dy teksteve do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'i komunikojë një kopje të vërtetuar secilit shtet anëtar të Këshillit të Europës dhe çdo shteti të ftuar për të aderuar në këtë Konventë.

Për Qeverinë e Republiës Austriake:

Ervin Lanc

Për Qeverinë e Mbretërisë së Belgjikës

Strasbourg me 24 Shtator 1980 A.J.Vranken

Për Qeverinë e Republikës së Qipros.

Për Qeverinë e Mbretërisë së Danimarkës:

Strasbourg, më 2 Prill 1981

Preben Arthur von der Hude

Për Qeverinë e Republikës së Finlandës,

Për Qeverinë e Republikës Franceze

Strasbourg, me 10 Nëntor 1982

Andre Chandsernagor

Për Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë.

Shtojcë:

Modele dhe skema të marrëveshjeve, statuseve dhe kontratave në fushën e bashkëpunimit ndërkufitar të bashkësive a autoriteteve territoriale.

Ky sistem i shkallëzuar i marrëveshjeve model është hartuar duke dalluar dy kategori kryesore të përcaktuara sipas nivelit të përfundimit të marrëveshjes:

- modele të marrëveshjeve ndërshtetërore për bashkëpunimin ndërkufitar në nivele rajonale dhe vendore,

- skema të marrëveshjeve, kontratave dhe statuseve që mund të vlejnë si mbështetje për bashkëpunimin ndërkufitar, ndërmjet autoriteteve ose bashkësive territoriale.

Siç tregohet dhe në tabelën e mëposhtme, vetëm dy modelet e marrëveshjeve ndërshtetërore mbi promovimin e bashkëpunimit ndërkufitar dhe mbi koordinimin rajonal ndërkufitar janë ekskluzivisht kompetencë e shteteve. Marrëveshjet e tjera ndërshtetërore vetëm sa fiksojnë kuadrin juridik që lejon realizimin e marrëveshjeve a kontratave ndërmjet autoriteteve ose bashkësive territoriale, skemat respektive të të cilave janë klasifikuar në kategorinë e dytë.

1.MODELE TË MARRËVESHJEVE MDËRSHTETËRORE. KLAUZOLA TË PËRGJITHSHME PËR MARRËVESHJET NDËRSHTETËRORE

1.1Model i marrëveshjes ndërshtetërore mbi promovimin e bashkëpunimit ndërkufitar.

1.2 Model i marrëveshjes ndërshtetërore mbi koordinimin rajonal ndërkufitar.

1.3 Modeli i marrëveshjes ndërshtetërore mbi koordinimin vendor ndërkufitar.

1.4 Modeli i marrëveshjes ndërshtetërore mbi kooperimin kontraktual ndërkufitar ndërmjet autoriteteve vendore.

1.5 Modeli i marrëveshjes ndërshtetërore lidhur me organizmat e bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet autoriteteve vendore.

2. Skema të marrëveshjeve, statuseve dhe kontratave që duhen përfunduar ndërmjet autoriteteve vendore.

1.1 Skemë e marrëveshjes për krijimin e një grupi koordinimi ndërmjet autoriteteve vendore.

1.2 Skemë e marrëveshjes së koordinimit në administrimin e punëve publike vendore ndërkufitare

1.3 Skemë e kontratës për krijimin e shoqatës ndërkufitare të së drejtës private.

1.4 Skemë e kontratës së ofrimit të shërbimeve ndërmjet bashkësive vendore kufitare (të llojit "e drejtë private").

1.5 Skemë e kontratës së ofrimit të shërbimeve ndërmjet bashkësive vendore kufitare të llojit "e drejtë publike".

1.6 Skemë e marrëveshjes për krijimin e organizmave të bashkëpunimit ndërkomunal ndërkufitar.

MODELE TË MARRËVESHJES NDËRSHTETËRORE

Shënim fillestar: sistemi i marrëveshjeve ndërshtetërore ka për qëllim veçanërisht të fiksojë në mënyrë preçize kuadrin, format dhe limitet në të cilat Shtetet dëshirojnë që të kryhen veprimet e bashkësive territoriale, si dhe të eleminojë paqartësitë juridike që mund të provokojnë probleme.

Përveç kësaj, përfundimi i marrëveshjeve ndërshtetërore ndërmjet shteteve të interesuara, që favorizojnë zhvillimin e bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet autoriteteve vendore pa dyshim do të kishte pasoja të favorshme në planet e mëposhtme:

vulosja zyrtare e ligjshmërisë së këtyre procedurave të bashkëpunimit dhe inkurajimi për autoritetet vendore përkatëse;

roli dhe kushtet e ndërhyrjes së autoriteteve të tutelës të mbikqyrjes a të kontrollit;

misioni i informimit reciprok të shteteve;

lidhjet që mund të krijohen, ndërmjet këtyre formave të bashkëpunimit dhe procedurave të tjera të këshillimit në nivel kufitar;

ndryshimi i disa rregullave juridike ose disa interpretimeve të këtyre të fundit që krijojnë pengesa për bashkëpunimin ndërkufitar etj.

Sistemi i modeleve të marrëveshjes përshkruar në skemën e mësipërme, u lejon qeverive që të vendosin bashkëpunimin kufitar në kuadrin që u përshtatet më mirë atyre, duke u nisur nga minimumi i krijuar nga marrëveshja mbi promovimin e bashkëpunimit ndërkufitar (1.1) dhe duke hapur "sirtaret" që ata kanë pranuar (modele të marrëveshjeve nga 1.2 deri më 1.5). Hapja e një "sirtari" të vetëm e shumë "sirtareve" madje e tërësisë së "sirtareve" mund të konceptohet në të njëjtën kohë ose me periudha të njëpasnjëshme. Është evidente që në rastin e marrëveshjeve ndërmjet shteteve që kanë tashmë sisteme të së drejtës shumë të përafërta, p.sh. shtetet skandinave, nuk mund të jetë e detyrueshme nevoja për marrëveshje kaq preçize.

KLAUZOLA TË PËRGJITHSHME PËR MODELET E MARRËVESHJES 1.1. DERI MË 1.5

Neni a

1. Konsiderohen si autoritet vendor, në kuptimin e kësaj marrëveshjeje, autoriteti, bashkësitë ose organizmat që ushtrojnë funksione vendore sipas së drejtës së brendshme të çdo shteti.

2. Konsiderohen si "autoritete rajonale" në kuptimin e kësaj marrëveshjeje autoritetet, bashkësitë ose organizmat, që ushtrojnë funksione vendore sipas së drejtës të brendshme të çdo Shteti.

Neni b

Kjo marrëveshje nuk cenon mënyrat e bashkëpunimit ndërkufitar ekzistuese, të formave të ndryshme, në shtetet palë dhe në veçanti ato që janë hartuar në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare.

Neni c

Palët do të informojnë autoritetet rajonale dhe vendore për mënyrat e veprimit që u afrohen atyre dhe do t'i inkurajojnë ato për përdorimin e tyre.

Neni d

Termat “autoritete superiore” në këtë marrëveshje i përkasin autoriteteve qeveritare, të tutelës, të kontrollit, të mbikëqyrjes, siç janë përcaktuar nga çdo Palë.

Neni e

Shtrirja dhe natyra e kompetencave të autoriteteve vendore siç janë përcaktuar nga e drejta e brendshme e shteteve palë nuk janë ndryshuar aspak nga kjo marrëveshje.

Neni f

Çdo shtet në çdo moment mund të zgjedhë zonat e territorit të vet, objektet e format e bashkëpunimit, që janë përjashtuar nga kjo marrëveshje. Megjithatë, kjo përzgjedhje nuk mund të cënojë të drejtat e fituara në kuadrin e bashkëpunimeve tashmë të realizuara.

Neni g

Palët e informojnë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës për aktivitetet e komisioneve, komiteteve dhe organeve të tjera të ngarkuara me misionin e zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

Neni h

Palët mund t’i bëjnë kësaj marrëveshjeje nëpërmjet shkëmbimit të thjeshtë të shënimeve ndryshime pak të rëndësishme, që eksperienca ka diktuar lidhur me përshtatshmërinë.

Neni 2

Palët përpiqen, në marrëveshje midis tyre, t’u sigurojnë autoriteteve rajonale në juridiksionin e tyre mjetet e nevojshme që i lejojnë ato të vendosin ndërmjet tyre lidhje bashkëpunimi.

Neni 3

Ato përpiqen të favorizojnë nismat e autoriteteve vendore me qëllim që të vendosin dhe të zhvillojnë bashkëpunimin ndërkufitar.

Neni 4

Në rastin e një bashkëpunimi ndërkufitar ndërmarrë konform kësaj marrëveshjeje, autoritetet dhe bashkësitë vendore e rajonale përkatëse do të gëzojnë të njëjtat lehtësira e mbrojtje si në rastin kur bashkëpunimi ushtrohej në planin e brendshëm.

Autoritetet kompetente të çdo Pale do të përpiqen që të parashikohen kreditë e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve të funksionimit të organeve të ngarkuara me promovimin e bashkëpunimit ndërkufitar, siguruar nga kjo marrëveshje.

Neni 5

Çdo Palë do të ngarkojë atë organ, komision ose institucion që do të zgjidhet për shqyrtimin e legjislacionit dhe rregullores kombëtare në fuqi, me qëllim që të propozohet ndryshimi i dispozitave që mund të pengojnë zhvillimin e bashkëpunimit vendor ndërkufitar. Këto organe do të

studiojnë veçanërisht përmirësimin e dispozitave fiskale dhe të doganave, rregullat në fushën e shkëmbimit dhe transferimit të kapitaleve, si dhe procedurat që rregullojnë ndërhyrjen e autoriteteve të larta, sidomos në fushën e tutelës ose të kontrollit.

Para se të merren masat e synuara në paragrafin e mëparshëm, Palët e interesuara do të këshillohen, nëse është e nevojshme dhe do t'i komunikojnë njëra-tjetrës informacionet e nevojshme.

Neni 6

Palët do të kujdesen për të kërkuar nëpërmjet rrugës së arbitrazhit, ose ndryshe, zgjidhjen e marrëveshjeve të rëndësisë për të cilat rregullorja paraprake do të ishte e nevojshme në mbarëvajtjen e veprimeve të bashkëpunimit ndërkufitar.

1.2. Model i marrëveshjes ndërshtetërore mbi koordinimin rajonal ndërkufitar.

Shënim fillestar: Kjo marrëveshje mund ose të përfundohet individualisht, ose me një a disa modele të marrëveshjeve ndërshtetëtrore (tekstet 1,1 deri me 1,5).

Neni 1

Me qëllim që të promovohet (koordinimi) ndërkufitar në rajonin e përcaktuar në shtojcën e kësaj marrëveshjeje, Palët krijojnë një Komision mikst (i quajtur më poshtë "Komisioni") i dalë, në rast nevoje, nga një a disa komitete rajonale (i quajtur më poshtë "Komitete") të ngarkuara me trajtimin e çështjeve që lidhen me këshillimin ndërkufitar.

Neni 2

1. Komisioni dhe Komiteti janë krijuar nga delegacione të formuara me nismën e secilës Palë.

2. Delegacionet e Komisionit përbëhen nga 8 anëtarë maksimumi, ndërmjet të cilëve të paktën 3 përfaqësojnë autoritetet rajonale. Kryetarët e delegacioneve në Komitete, ose përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë, me votë konsultative, në punimet e Komisionit.

3. Komitete të krijuara nga..... Delegacione prej..... anëtarësh, janë formuar me nismën e Komisionit dhe në mirëkuptim me autoritetet rajonale dhe vendore të zonave kufitare të mbuluara nga kjo marrëveshje. Delegacionet në Komitete do të përbëhen nga përfaqësues të këtyre autoriteteve ose nga organizma rajonal e vendore. Përveç kësaj, një i deleguar do të zgjidhet nga autoritetet qendrore. Ky i fundit do të jetë, në rast nevoje, i zgjedhur ndërmjet organeve që përfaqësojnë autoritetet qëndrore në zonat kufitare që janë në kompetencë të Komiteteve.

4. Komisioni mblidhet të paktën një herë në vit. Komitetet mblidhen aq shpesh sa e kërkojnë nevojat, por të paktën dy herë në vit.

5. Komisioni dhe Komitetet hartojnë rregulloren e tyre të brendshme.

Neni 3

Secila Palë përballon shpenzimet e delegacionit të saj në Komision. Shpenzimet e delegacioneve në Komitete do të përballohen nga autoritetet që përbëjnë këto delegacione.

Neni 4

Me qëllim që të sigurohet bashkëpunimi dhe vazhdimësia e punimeve të Komisionit dhe komiteteve, Palët krijojnë, sa herë që lind nevoja, një sekretariat, përbërja e të cilit, selia, modalitetet e funksionimit dhe financimi janë përcaktuar nga një aranxhim i përshtatshëm ndërmjet Palëve, me propozim të Komisionit ose në mungesë, nga komisioni vetë.

Neni 5

Zonat kufitare ku shtrihet zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të përcaktohen në një shtojcë të marrëveshjes. Përmbajtja e kësaj shtojce mund të ndryshohet thjesht nëpërmjet shkëmbimit të notave.

Neni 6

1. Çështjet që janë objekt i koordinimit ndërkufitar janë ato që shtrohen në fushat e mëposhtme:

zhvillimi urban dhe rajonal;

transporti dhe komunikacionet (transporte të përbashkëta, rrugë dhe autostrada, aeroporte të përbashkëta, rrugë ujore, porte detare etj);

energjia (centrale për prodhimin e energjisë, furnizime me gaz, elektricitet, ujë etj.);

mbrojtja e natyrës (qyteza të mbrojtura, zona pushimi, parqe natyrore etj);

mbrojtja e ujrave (luftë kundër ndotjes së ujrave, ndërtimi i stacioneve të pastrimit të ujrave etj);

mbrojtja e ajrit (ndojtja atmosferike, lufta kundër zhurmës, zonat e qetësisë etj);

arsimi, formimi profesional dhe kërkimet;

shëndeti publik (p.sh përdorimi i një qendre përkujdesi të vendosur në njërën nga zonat nga banorët e zonës tjetër);

kultura, argëtimet dhe sportet (teatro, orkestra, qendra sportive, kampe pushimi, shtëpi të rinjsh, etj)

ndihmat e ndërsjella në rast katastrofe (zjarre, përmbytje, epidemi, aksidente avioni, tërmete, aksidente në mal etj).

turizëm (realizime të përbashkëta për të promovuar turizmin);

problemet e ngritura nga punonjëit kufitarë (lehtësira transporti, strehimi, mbrojtje sociale, çështje fiskale, probleme të punësimit dhe të papunësisë etj);

projekte e aktivitete ekonomike (projekte të ngulimeve industriale etj);

projekte të ndryshme (uzinë e përpunimit të mbeturinave, ndërtimi i kanaleve kulluese etj);

përmirësimi i strukturës agrare;

infrastruktura sociale;

1. Palët mund të bien dakord thjesht nëpërmjet shkëmbimit të notave që të ndryshojnë këtë listë.

Neni 7

1. Përveç dispozitave të veçanta, Komisioni është ngarkuar të trajtojë çështje të përgjithshme dhe çështjet parimore, si hartimi i programeve për komitete, koordinimi dhe kontaktet me administratat qëndrore të interesuara, si dhe nga komisionet mikse të krijuara para hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje.

2. Komisioni në veçanti ka për detyrë të kontaktojë, në rast nevoje, qeveritë respektive të rekomandimeve të saj dhe të komiteteve të saj, si dhe projekte eventuale lidhur me përfundimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.

3. Komisioni mund t'i drejtohet ekspertëve për studimin e çështjeve të veçanta.

Neni 8

1. Komitete kanë kryesisht për detyrë të studiojnë problemet që lindin në fushat e përmendura në nenin 6 dhe të nxjerrin propozime dhe rekomandime në këtë rast. Ato mund të trajtohen nga komisioni, autoritetet qendrore, rajonale e vendore të palëve si dhe nga institucionet,

shoqatat ose organizmat e së drejtës publike a private. Ata mund të trajtohen gjithashtu me vetë nismë.

2. Komitetet mund të krijojnë grupe pune për studimin e këtyre problemeve. Ato mund t'i drejtohen edhe ekspertëve dhe të kërkojnë mendime juridike ose roserte teknike. Komitetet duhe të kërkojnë që me një konsultim sa më gjërë që të jetë e mundur të arrihet me rezultate konform interesit të popullsisë përkatëse.

Neni 9

1. Komitetet informojnë Komisionin për çështjet që kanë shtruar për shqyrtim si dhe për konkluzionet e arritura.

2. Nëse konkluzionet kërkojnë vendime në shkallë Komisioni a qeveritë respektive, Komitetet formulojnë rekomandime për komisionin.

Neni 10

1. Komisionet, si dhe komitetet kanë aftësinë ligjore për të rregulluar në marrëveshje me anëtarët e tyre, çështje me interes të përbashkët, për aq sa anëtarët e tyre kanë kompetencën sipas legjislacionit respektiv të Palëve.

2. Komisioni dhe Kontrolli informojnë njëri-tjetrin për vendimet e marra në këtë drejtim.

Neni 11

1. Delegacionet në gjirin e komisionit ose të komiteteve informojnë njëri-tjetrin për masat e marra nga autoritetet kompetente në vazhdim të rekomandimeve të formuluara ose të projektmarrëveshjeve të harturara konform nenit 7.2 dhe nenit 9.2.

2. Komisioni dhe komitetet shqyrtojnë vazhdimësinë që i duhet dhënë dispozitave të marra nga autoritetet kompetente përmendur në paragrafin e parë.

1.3. Modeli i marrëveshjes ndërshtetërore mbi koordinimin vendor ndërkufitar

Notë fillestare: Kjo marrëveshje ose mund të jetë e përfunduar invidualisht ose bashkërisht me një a disa modele marrëveshjesh ndërshtetërore (tekstet 1.1 deri më 1.5).

Neni 1

Me qëllim të një informimi reciprok dhe të zhvillimit të koordinimit ndërmjet autoriteteve vendore nga njëra anë dhe tjetra anë e kufirit, Palët ftojnë këto autoritete për të shqyrtuar së bashku problemet vendore me interes të përbashkët në kuadrin e grupeve të koordinimit.

Neni 2

Rregullat e funksionimit të këtyre grupeve përcaktohen me marrëveshje ndërmjet anëtarëve të tyre. Autoritetet superiore i bashkëngjiten punimeve të tyre ose informohen për to.

Grupet e këshillimit i bashkohen punimeve të komisioneve rajonale të koordinimit ndërkufitar në kushtet e përcaktuara nga këto të fundit, nëse janë krijuar komisione të tilla në rajonin në fjalë. Reciprokisht, këto komisione sjellin ndihmesën e tyre në punimet e grupeve.

Ato, gjithashtu, mund të ndërhyjë si grupe konsultimi në kuadrin e zbatimit të marrëveshjeve ndërshtetërore me objekt të veçantë e të përfunduara në fushën e bashkëpunimit ndërkufitar.

Neni 3

Thirrja e grupeve të koordinimit është të sigurojë shkëmbimin e informacioneve, konsultimin reciprok, studimin e çështjeve me interes të përbashkët, përcaktimin e objektivave të njëjta.

Aktiviteti i tyre kryhet duke respektuar përgjegjësitë e vetë anëtarëve të tyre dhe nuk kërkon asnjë transferim kompetence. Megjithatë, në kuadrin e marrëveshjeve të bashkëpunimit, anëtarët e këtyre grupeve mund të vlerësojnë bashkarisht masat e kufizimit që udhëheqin veprimet e tyre respektive ose procedurat e konsultimeve paraprake që ata mendojnë të ndjekin.

Neni 4 (variant)

Me qëllim që të lehtësohet veprimtaria i këtyre grupeve të koordinimit, autoritetet vendore të interesuara mund të krijojnë, në kufijtë e pushteteve që atyre u jep e drejta e brendshme, shoqata të destinuara për t'i dhënë një mbështetje juridike bashkëpunimit të tyre.

Këto shoqata do të krijohen në bazë të së drejtës civile të shoqatave dhe të së drejtës tregtare të njërit prej shteteve përkatëse. Për aplikimin e regjimit juridik të miratuar, në rast nevoje, bëhet përjashtim nga kushtet, formalitetet ose autorizimet e veçanta të lidhura me kombësinë e anëtarëve të këtyre shoqatave.

Këto informacione dhënë autoriteteve të larta, konform nenit 2, përfshijnë çdo të dhënë mbi aktivitetet e shoqatave të përmendura në këtë nen.

1.4. Model i marrëveshjes ndërshtetërore mbi bashkëpunimin ndërkufitar lidhur me kontratë midis autoriteteve vendore.

Shënim fillestar: Kjo marrëveshje ose mund të përfundojë individualisht, ose së bashku me një a disa modele të marrëveshjeve ndërshtetërore (tekstet 1.1 deri më 1.5).

Neni 1

Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve vendore vihet në jetë sidomos nëpërmjet kontratave që kanë objekt administrativ, ekonomik ose teknik.

Neni 2

Kontratat e bashkëpunimit ndërkufitar përfundohen nga autoritetet vendore në kufijtë e kompetencës së tyre, siç rezulton nga e drejta e brendshme. Ato kanë të bëjnë veçanërisht me lëvrimin e pagimeve dhe shërbimeve, zbatimin e aksioneve të përbashkëta, me krijimin e shoqatave të krijuara në bazë të së drejtës civile a tregtare të njërit prej shteteve palë ose me pjesëmarrjen në të tilla shoqata.

Neni 3

Bashkëkontraktuesit përcaktojnë të drejtën që zbatohet në të ashtuquajturat kontrata, duke iu referuar të drejtës së kontratave (publike dhe private) të njërit prej shteteve palë në këtë marrëveshje.

Ata përcaktojnë gjithashtu sa të jetë e nevojshme shkeljet që mund t'i bëhen dispozitave joshtrënguese të kësaj të drejte.

Me qenësinë e kontratës, e drejta e zbatueshme është ajo e shtetit, nga i cili varet autoriteti vendor, i cili sipas kontratës është i ngarkuar me zbatimin e pagimit me të rëndësishëm në natyrë, ose në mungesë, autoriteti vendor angazhimi financiar i të cilit është më i rëndësishmi. Për çdo arsye, qytetarët e secilit prej autoriteteve vendore që janë në kontratë, ruajnë kundrejt këtyre të fundit çdo të drejtë aksioni dhe ndihme që ato do të gëzonin ndaj të ashtuquajturave autoritete nëse këto të fundit do të kishin mbajtur për vetë ngarkesën për të kryer pagime, lëvrime a shërbime.

Neni 4

Projektet e konkluzionit ose modifikimit të kontratave i nënshtrohen njëkohësisht në çdo shtet rregullave të zakonshme që fiksojnë ndërhyrjen e autoriteteve superiore. Megjithatë, asnjë miratim nuk kërkohet nga ana e autoriteteve që janë palë në kontratë. Çdo vendim i një autoriteti të lartë që synon të pengojë konkluzionin a aplikimin ose të provokojë prishjen e një kontrate të bashkëpunimit ndërkufitar, nënkupton një koordinim paraprak me autoritete të larta homologe të shteteve të tjera të interesuara.

Neni 5

Në rast padie, drejtësia do të zbatohet nga juridiksioni kompetent. Megjithatë, kontratat e bashkëpunimit ndërkufitar mund të parashikojnë klauzola arbitrazhi. Përdoruesit dhe të tretët ruajnë ndërkohë rrugët ekzistuese të ankesës kundër autoriteteve vendore të shtetit nga i cili varen, me kusht që këto autoritete t'i kundërvihen bashkëkontraktuesit që nuk paraqitet në gjyq.

Autoritetet e larta do të marrin të gjitha masat që janë në pushtetin e tyre, për të siguruar një zbatim të shpejtë të vendimeve juridike, çfarëdo që të jetë tradicionaliteti i gjykatës që i ka nxjerrë ato.

Neni 6

Kontratat e përfunduara në kuadrin e kësaj marrëveshjeje mbeten në fuqi pas denoncimit të saj. Megjithatë, kontratat do të përmbajnë një klauzolë që autorizon palët për t'i prishur ato, duke respektuar një paralajmërim të paktën pesëvjeçar në rastin kur marrëveshja aktuale do të ishte denoncuar vetë. Shtetet palë do të kenë fuqinë të provokojnë zbatimin e kësaj klauzole.

1.5. Model i marrëveshjes ndërshtetërore mbi bashkëpunimin ndërkufitar ndërmjet autoriteteve vendore.

Shënim fillestar: Kjo marrëveshje ose mund të përfundohet individualisht, ose bashkarisht me një a disa modele të marrëveshjeve ndërshtetërore (tekstet 1.1-1.5). Për objektet që ato kanë pranuar të realizojnë sipas të drejtës së brendshme në kuadrin e një shoqate anjë sindikate, bashkësitë vendore edhe persona të tjerë të së drejtës publike mund të marrin pjesë në shoqata ose sindikata të pushtetit vendor të krijuara në territorin e palës tjetër konform të drejtës së brendshme të kësaj të fundit.

Neni 2

Në limitet e kompetencave të anëtarëve të saj, shoqatat a sindikatat e përmendura në nenin 1, kanë të drejtën të ushtrojnë aktivitetet e tyre që varen nga objekti i tyre social në territorin e secilës palë të interesuar. Ato i nënshtrohen rregullave të diktuara nga ky shtet, me përjashtim të ndryshimit të pranuar nga ky i fundit.

Neni 3

1. Akti formues i shoqatës a sindikatës dhe statuset e veçanta si dhe modifikimet e këtyre akteve i nënshtrohen miratimit të autoriteteve të larta të të gjithë kolekitivave vendore pjesëmarrëse. E njëjta gjë është edhe për hyrjen në një shoqatë a sindikatë tashmë ekzistuese.

2. Këto akte dhe miratimi i tyre do t'i bëhen të ditur gjithë popullsisë të interesuar sipas mënyrave të publicitetit të zbatuara në çdo shtet. E njëjta që është për çdo ndryshim të drejtuesve zyrtarë dhe për çdo vendim lidhur me personat e aftë për të drejtuar shoqatën a sindikatën dhe kufijtë e pushtetit të tyre.

3. Aktet e mësipërme do të hartohen në gjuhët zyrtare që përdoren në secilin nga shtetet, ku ato do të kenë veprim. Tekstet e ndryshme sigurisht që do të jenë të besuara.

Neni 4

1. Statuset rregullojnë rosertet e së drejtës të shoqatës a sindikatës. Ato përfshijnë fushat e kërkuara nga legjislacioni që i drejton, konform nenit 1. Në të gjitha rastet, ato zgjedhin anëtarët, emrin dhe selinë. Ato përcaktojnë misionin e shoqatës a të sindikatës dhe në rast nevoje funksionet dhe vendin e vendosjes së instalimeve, që do të kryhen. Ato rregullojnë kushte në të cilat janë zgjedhur organet e drejtimit dhe administrimit, masën e angazhimit të pjesëtarëve dhe kontributin e tyre në ngarkesat e përbashkëta. Organet drejtuese duhet të përfshijnë të paktën një përfaqësues të bashkësive vendore anëtarë të çdo vendi. Ato fiksojnë përbërjen dhe mënyrën e diskutimit të çështjeve në Asamblenë e Përgjithshme, formën e procesverbaleve të seancës, mënyrat e shpërbërjes dhe likuidimit, si dhe rregullat e zbatura në fushën e buxhetit dhe të llogarive.

2. Statuset përveç kësaj duhet të kenë një dispozitë, që i lejon pjesmarrësit që të tërhiqen nga shoqata duke fiksuar kohëzgjatjen e afatit, likujdimin e borxheve të tyre të rastit ndaj shoqatës dhe dëmshpërblimin e saj, d.m.th. të ekspertëve, për investimet dhe shpenzimet e realizuara a ekspozuara nga shoqata në përfitim ose në shkarkim të të ashtuquajturve pjesëmarrës. Ato fiksojnë gjithashtu kushtet e dorëheqjes nga detyra ose të përjashtimit të një pjesëmarrësi për shkak të moszbatimit të angazhimeve të tij.

Neni 5

Palët angazhohen të akordojnë autorizimet e nevojshme për zbatimin, në territorin e tyre nga ana e shoqatës ose sindikatës, të misionit që kanë me përjashtim të kërkesave të rendit dhe të sigurisë publike.

Neni 6

Kur nga aplikimi i së drejtës së brendshme, shoqata a sindikata nuk mund të disponojë në territorin e një shteti disa pushtete, të drejta a avantazhe të nevojshme për plotësimin e mirë të misionit të vet në favor të bashkësive vendore, anëtarë, që varen nga ky shtet, këto të fundit do të kenë të drejtën dhe detyrën për të ndërhyrë në vendin e shoqatës a sindikatës, me qëllim që të ushtrojnë ose të sigurojnë këto pushtete të drejta e avantazhe.

Neni 7

1. Pushtetet e tutelës ose kontrollit mbi shoqatën a sindikatën ushtrohenn konform të drejtës së brendshme, nga autoritetet kompetente të shtetit të vet. Këto të fundit kujdesen gjithashtu për mbrojtjen e interesave të bashkësive vendore që varen nga shtetet e tjera.

2. Autoritetet kompetente të vendeve të tjera kanë të drejtë informimi mbi veprimtaritë dhe vendimet e shoqatës a sindikatës dhe akteve të marra në ushtrimin e tutelës ose kontrollit. Ato marrin veçanërisht, me kërkesën e tyre, tekstet e miratura dhe procesverbalet e mbledhjeve të organeve të shoqatës a sindikatës si dhe me autoritetet e tutelës a kontrollit të saj, t'u drejtojnë atyre vërejtje dhe t'u kërkojnë të konsultohen drejtpërdrejt për raste dhe çështje të përcaktuara.

3. Autoritetet kompetente të shteteve të tjera do të kenë gjithashtu të drejtën të njoftojnë shoqatën a sindikatën se ato do të kundërshtojnë që bashkësitë, që janë nën kompetencën e tyre të vazhdojnë të marrin pjesë në shoqatë a sindikatë. Ky njoftim i motivuar siç duhet do të jetë si një shkak përjashtimi dhe do të merret si i tillë në statuse. Autoritetet e përmendura në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni kanë gjithashtu të drejtën që përfaqësohen nga një i deleguar pranë organeve drejtuese të shoqatës a sindikatës dhe ky i deleguar të ketë aftësinë për të asistuar në të gjitha mbledhjet e të ashtuquajturave organe dhe të pranojnë urdhërat ditore dhe procesverbalet.

Neni 8

Pagimet dhe lëvrimet për të cilat do të ngarkohet shoqata a sindikata në territorin e anëtarëve tësaj, në përputhje me statuset e saj, do të kryhen nën përgjegjësinë e saj dhe në shkarkim të plotë të tyre. Shoqata a sindikata do të jetë sigurisht përgjegjëse ndaj autoriteteve vendore në vendin e të cilëve pagimet dhe lëvrimet do të ishin kryer të gjithë të drejtat, veprimet dhe ndihmat që ata do të gëzonin ndaj të ashtuquajturave autoritete, nëse këto të fundit do të kryenin vetë pagimet a lëvrimet. Autoritetet që do të ishin objekt i një veprimi të tillë, mund të drejtojnë ankesë kundër shoqatës a sindikatës.

Neni 9

1. Në pamundësi pajtimi, ankesat lidhur me juridiksionin e shoqatës a sindikatës, duke ia kundërvënë këtë të fundit anëtarëve të saj, ose 2 a disa anëtaarëve, paraqiten përpara autoriteteve administrative dhe juridike të shtetit në të cilën shoqata a sindikata ka selinë.

2. Të gjitha paditë e tjera përveç atyre të parashikuar anë paragrafin 1, paraqiten përpara autoriteteve administrative dhe juridiksioneve kompetente sipas rregullave ordinere të zbatuara kur të interesuarit i besojnë zgjedhjen e padisë një instance arbitrare që ata zgjedhin.

3. Shtetet palë do të marrin masat e nevojshme për të siguruar në territorin e tyre zbatimin e vendimeve dhe gjykimeve që dalin prej dispozitave paraprake.

Neni 10

Sindikatat dhe shoqatat e krijuara në zbatim të kësaj marrëveshjeje mbeten në fund pas denoncimit të kësaj të fundit, pa dëmtuar megjithatë dispozitat e nenit 7, paragrafi

2. SKEMA E MARRËVESHJEVE, STATUSEVE DHE TË KONTRATAVE QË DUHEN PËRFUNDUAR NDËRMJET AUTORITETEVE VENDORE

Notë fillestare:

Skemat e marrëveshjeve të kontratave dhe statuseve të destinuara për autoritetet vendore.

Në të njëjtën mënyrë si për shtetet, bashkësive vendore duhet t'u ofrohet një përzgjedhje marrëveshjesh e kontratash, përzgjedhje që tashmë ekziston në disa shtete siç tregohet në dokumentacionin e shumtë të mbledhur për marrëveshjet.

Sistemi i propozuar përfshin gjashtë skema të marrëveshjeve, kontratave dhe statuseve që i korrespondojnë shkallëve dhe formulave të ndryshme të bashkëpunimit ndërkufitar vendor. Këto skema, sipas objektit dhe gjendjes së legjislacioneve kombëtare, janë ose të ndjeshme për një përdorim imediat, ose të varura nga miratimi i një marrëveshjeje ndërshtetërore që rregullon përdorimin e tyre.

Në një mënyrë të përgjithshme, konkluzioni i marrëveshjeve ndërshtetërore, dhe aty ku nuk duket absolutisht i domosdoshëm, mund të kontribuonte për të përcaktuar kushtet e ndihmës për këtë marrëveshje nga ana e bashkësive vendore. Përfundimi i marrëveshjeve ndërshtetërore duket që i drejtohet në çdo rast për ndihmë marrëveshjes së shënuar në pikën 2.6 (organe të bashkëpunimit ndërkufitar). Sistemi i këtyre skemave të marrëveshjeve të destinuara për bashkësitë vendore, i korrespondon modeleve të marrëveshjeve ndërshtetërore. Do të gjendet një referencë për marrëveshjet, ndërshtetërore në shënimet fillestare që paraprijnë çdo skeme. Atëherë do të jetë e mundur të përfshihen marrëveshjet dhe organizmat e krijuara në nivel vendor dhe strukturat e koordinimit ndërkufitar që do të krijohen në nivel rajonal a kombëtar. Kështu p.sh. për grupet vendore të koordinimit (skema 2.1) mund të integroheshin në strukturën e komisioneve, komiteteve dhe grupeve të punës të parashikuara në modelin e marrëveshjes ndërshtetërore për koordinimin rajonal ndërkufitar (shiko 1.2).

Është vendi, gjithashtu, për të përmendur që këto modele janë konceptuar mbi një bazë skematike, sepse nuk është e mundur të imagjinohet terësia e problemeve që mund të lindin për çdo rast. Këto skema përbëjnë një guidë të çmuar, por ato mund të ndryshohen sipas nevojave të bashkësive që do t'i përdorin.

I takon sigurisht bashkësive vendore, që të përcaktojnë mënyrën se si mendojnë të aktivizojnë qytetarët në koordinimin ndërkufitar, sidomos në fushën social-kulturore. Një pjesëmarrje e tillë do të kontribuonte pa dyshim për heqjen e disa pengesave në bashkëpunimin ndërkufitar.

Koordinimi i mbështetur nga interesi i qytetarëve do të gëzonte kështu një bazë të fortë. Një nga mënyrat për të vendosur pjesëmarrjen e publikut mund të ishte mbështetja në një shoqatë. Kështu, një nga skemat e marrëveshjeve (shiko 2.3) përbën krijimin e një shoqate të së drejtës private.

2.1 Skema e marrëveshjes për krjimin e një grupi të koordinimit ndërmjet autoriteteve vendore.

Notë fillestare: Normalisht, është e mundur krijimi i këtij lloji grupi pa patur ndihmën e marrëveshjeve ndërshtetërore. Shembuj të shumtë dëshojnë këtë mundësi, megjithatë, nëse ekziston paqartësi të karakterit juridik a të tjera, do të duhej që kushtet e ndihmës për këtë lloj koordinimi të ishin të fiksuara në një marrëveshje ndërshtetërore (shiko modelin 1.3).

Qëllimi i grupit të koordinimit dhe selia

Neni 1

Autoritetet vendore angazhohen të koordinojnë përpjekjet e tyre në fushat e mëposhtme që varen nga kompetenca e tyre, ose t'i referohen "problemeve vendore të fqinjësisë". Për këtë qëllim ato krijojnë një grup koordinimi si më poshtë të quajtur "grupi" selia e të cilit është në ……

Misioni i grupit është vendosja e shkëmbimit të informacioneve, koordinimi dhe konsultimi ndërmjet anëtarëve të tij në fushat e përcaktuar në paragrafin e mëparshëm. Autoritetet anëtarë angazhohen t'i transmetojnë atij të gjitha informacionet e nevojshme për plotësimin e misionit të tij dhe të konsultohen në gjirin e tij përpara miratimit të vendimeve ose masave që interesojnë fushat e lartpërmendura.

Anëtarët e grupit

Neni 2

Çdo autoritet vendor Palë përfaqësohet në grup nga një delegacion prej ……anëtarësh të deleguar prej tij. Çdo delegacion mundet, që në marrëveshje me grupin të shoqërohet nga përfaqësues të organizmave social-ekonomike private dhe të ekspertëve.

Variant i mundshëm: Numri i anëtarëve të çdo delegacioni mund të ndryshojë. Mund të bëhen anëtarë grupi autoritetet vendore dhe rajonale, grupet social-ekonomike dhe personat fizikë që do të nënshkruajnë në këtë marrëveshje. Grupi vendos për pranimin e anëtarëve të rinj. Çdo delegacion, në marrëveshje me grupin, mund të shoqërohet nga përfaqësues të organizmave privatë ose ekspertë.

Kompetencat e grupit

Neni 3

Grupi të trajtojë të gjitha çështjet e përcaktuara në nenin 1. Procesverbali do të regjistrojë të gjitha çështjet për të cilat ka dalë një konsensus si dhe rekomandimet që ka menduar t'i drejtojë autoriteteve ose grupimeve përkatëse.

Grupi është i aftë për të kryer studime dhe anketa për çështjet që janë kompetencë e tij.

Neni 4

Anëtarët e grupit mund të vendosin t'i besojnë grupit zbatimin e disa detyrave praktike mjaft të përcaktuara. Grupi përveç të tjerave mund të plotësojë të gjitha misionet, që i janë besuar nga institucione të tjera.

Funksioni i grupit

Neni 5

Grupi mban llogarinë e tij të brendshme.

Neni 6

Grupit thirret sipas rregullit të përgjithshëm dy herë në vit ose me kërkesë të një të tretës së anëtarëve që propozojnë regjistrimin e një pike në rendin ditor.

Thirrja dhe dërgimi i rendit ditor duhet të bëhet të paktën 15 ditë përpara me qëllim që të lejojë përgatitjen e diskutimeve në gjirin e çdo institucioni të përfaqësuar.

Neni 7

Grupi zgjedh në gjirin e tij një zyrë permanente, të cilës i përcakton kompetencat dhe përbërjen.

Kryesia ushtrohet sipas rregullores së brendshme dhe në mungesë nga anëtari më i moshuar.

Lidhjet me të tretët dhe autoritetet e larta

Neni 8

Në lidhjet me të tretët, grupi përfaqësohet nga Presidenti i tij, me përjashtim të dispozitave të veçanta të rregullores së brendshme. Autoritetet e larta nga të cilat varen anëtarët e grupit mund të marrin nga ky i fundit, me kërkesën e tyre, çdo informacion mbi punimet e grupit dhe kanë aftësinë që të dërgojnë aty një vëzhgues.

Sekretariati dhe financimi

Neni 9

Sekretaria sigurohet nga një prej institucioneve anëtarë (me ose pa një sistem rinovimi çdo vit).

Çdo bashkësi duhet të kontribuojë për shpenzimet e sekretarisë sipas modaliteteve të fiksuara më poshtë:

Në parim dërgimi i informacioneve dhe dokumentacioneve bëhet në gjuhët e shtetit nga ato dalin.

Aderimet dhe tërheqjet

Neni 10

Mund të bëhen anëtarë grupi autoritetet vendore dhe rajonale që do të nënshkruhen në këtë marrëveshje. Grupi vendos për pranimin e anëtarëve të rinj.

Neni 11

Çdo anëtar mund të tërhiqet nga grupi me një njoftim të thjeshtë të vendimit të tij dhënë Presidentit. Tërheqja e një anëtari nuk prek funksionimin e grupit me përjashtim të vendimit kategorik të grupit.

Neni 12

Palët do të informojnë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës për përfundimin e kësaj marrëveshjeje dhe do t'i transmetojnë atij tekstin.

2.2. Skemë e marrëveshjes për bashkërendim në drejtimin e çështjeve publike vendore ndërkufitare

Notë fillestare: Në shumë shtete, kjo lloj marrëveshjeje bashkërendimi ndërkufitar është që tani e mundshme. Në pamundësi, kushtet e nevojës për këtë lloj marrëveshjeje duhej të fiksoheshin në kuadrin e një rregullimi ndërshtetëror paraprak (shiko modelin 1.3).

Qëllimi i marrëveshjes

Neni 1

Neni 1 përcakton qëllimin, objektin e marrëveshjes (p.sh. kërkimi i një zhvillimi të harmonizuar të rajonit kufitar) dhe fushat përkatëse.

Territori i synuar nga marrëveshja

Neni 2

Ka vend për të përcaktuar në nenin 2 territoret e synuara nga marrëveshja për të dy (a tre) anët e kufirit.

Angazhimi

Neni 3

Ky nen përcakton kushtet që lejojnë realizimin e qëllimeve të marrëveshjes (neni 1). Sipas objektit material të marrëveshjes, mund të parashikohen angazhimet e mëposhtme:

Palët angazhohen t'i nënshtrohen një procedure konsultimi paraprak para marrjes së vendimeve për një numër masash që ato duhet të marrin në kufijtë e kompetencave të tyre dhe të territorit që ato administrojnë;

Palët angazhohen të ndërmarrin në territorin e tyre dhe në kufijtë e kompetencave të tyre, masat e nevojshme për realizimin e objektivave të synuara në marrëveshje.

Koordinimi

Neni 4

Janë përcaktuar në nenin 4, sipas rrethanave dhe kërkesave të çdo marrëveshjeje, kushtet në të cilat kryhet bashkërendimi:

qoftë duke zgjedhur si grup koordinimi grupin me kompetencë të përgjithshme shënuar në skemën e marrëveshjes 2.1;

qoftë duke parashikuar krijimin e një grupi konsultimi specifik për objektin e synuar në këtë marrëveshje;

qoftë dhe nëpërmjet rrugës së kontakteve të thjeshta direkte bilaterale në nivelin e autoriteteve përkatëse.

Pajtimi

Neni 5

Çdo anëtar i grupit të koordinimit (çdo Palë nëse nuk ka grup) mund të kërkojë të kontaktojë grupin tjetër (Palën tjetër nëse s'ka grup) sa herë që vëren se marrëveshja nuk është zbatuar:

nëse nuk është kryer konsultimi paraprak;

nëse masat e marra nuk janë konform marrëveshjes;

ose nëse nuk janë marrë masat e nevojshme për realizimin e objektivit të marrëveshjes;

Nëse palët nuk arrijnë në një mirëkuptim, ato mund t'i drejtohen komisionit të pajtimit të ngarkuar për të kontrolluar respektimin e angazhimeve.

Instanca e Kontrollit

Neni 6

Palët mund të bien dakord për krijimin e një instance specifike të kontrollit të respektimit të angazhimeve të përbërë nga një numër i barabartë ekspertësh të zgjedhur nga të dy palët dhe të një eksperti të paanshëm, mënyra e zgjidhjes së të cilit është përcaktuar më parë. Instanca e kontrollit shpreh mendimin e saj për respektimin ose mosrespektimin e marrëveshjes. Ajo është e autorizuar për të bërë publike mendimin e saj.

Neni 7

Palët do të informojnë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës për konkluzionin e kësaj marrëveshjeje dhe do t'i transmetojnë atij tekstin.

2.3. Skema për krijimin e shoqatave ndërkufitare të së drejtës private.

Shënim fillestar: Kuptohet se pjesëmarrja e një bashkësie vendore të një shteti në një shoqatë të së drejtës private të një shteti tjetër është e mundur sipas të njëjtave rregulla dhe të njëjtave kushte që zbatohen në pjesëmarrjen e së ashtuquajturës bashkësi vendore në një shoqatë të së drejtës private të shtetit të saj. Nëse momentalisht nuk është rasti për këtë, kjo mundësi duhej të parashikohej qartë në kuadrin e një aranxhimi ndërkombëtar ndërmjet shteteve përkatëse (shiko modelet e marrëveshjeve ndërshtetërore 1.3 dhe 1.4).

Normalisht, shoqatat e së drejtës private duhet t'i nënshtrohen rregullave të parashikuara nga ligji i vendit ku shoqata ka selinë e saj. Këtu më poshtë gjendet lista e dispozitave që duhej të përcaktonte statusi i tyre për aq sa ligji në fuqi nuk e parashikon. Nga ana tjetër, dispozitat lidhur me grupin e koordinimit (shiko skema 2.1) mund të aplikohen gjithashtu, mutatis mutandis, në këtë tip shoqatash.

Statuset përcaktojnë veçanërisht:

Anëtarët themelues të shoqatës dhe kushtet e pranimit të anëtarëve të rinj;

Emrin, selinë dhe formën juridike të shoqatës (duke iu referuar ligjit kombëtar).

Objektivin e shoqatës, kushtet e realizimit të objektivave të saj dhe mjetet, që ajo ka në dispozicion;

Organet e shoqatës dhe sidomos funksionet dhe mënyrën e funksionimit të asamblesë së përgjithshme (modalitetet e përfaqësimit dhe votimin);

Zgjedhjen e administratorëve dhe drejtuesve dhe pushtetin e tyre;

Rëndësinë e angazhimit të bashkëpunëtorëve kundrejt të tretëve;

Kushtet e ndryshimit të statuseve dhe shkrirjes së shoqatës;

Angazhimin e Palëve për të informuar Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës lidhur me krijimin e një shoqate ndërkufitare dhe për t'i komunikuar atij statuset.

2.4. Skemë e Kontratës së lëvrimit a kryerjes së shërbimeve ndërmjet bashkësive vendore kufitare (të llojit "e drejtë private").

Shënim fillestar: Kuptohet që bashkësitë vendore kanë të drejtë të përfundojnë një tip të tillë kontrate me autoritetet vendore të vendeve të tjera. Nëse kjo kryesisht nuk kryhet, kjo mundësi duhej të parashikohej në kuadrin e një marrëveshjeje ndërshtetërore (shiko modelin 1.4).

Bëhet fjalë për një lloj kontrate për të cilën do të kenë nevojë bashkësitë vendore për shitjen, qiranë, tregun e punimeve, lëvrimin e pasurive a pagesave dhënien e të drejtave të shfrytëzimit etj. Nevoja e bashkësive vendore për kontrata tip të "së drejtës private" dhe të "së drejtës publike" është vështirë të përshkruhet. Megjithatë, kjo lloj kontrate mund të përdoret sa herë që sipas interpretimit të secilit vend, mund të flitet për një veprim më shumë të tipit komercial a ekonomik që do të kryente një person fizik a moral i së drejtës private. Për çdo veprim që ka të bëjë me ndërhyrjen e bashkësive vendore që ushtrojnë detyra të autoritetit publik, ka vend për të vlerësuar, përveç dispozitave të mëposhtme dhe rregullat shtesë të shtjellura në kontratën model të tipit "e drejtë publike" (shiko 2.5).

Palët

Neni 1 zgjedh Palët (dhe përcakton nëse marrëveshja është e hapur ose jo për bashkësi të tjera vendore).

Neni 2 përcakton problemet e lidhura me aftësinë e përgjithshme për të kontaktuar dhe veçanërisht përfituesit, modalitetet dhe kushtet. Nëse ka vend, ky nen jep gjithashtu rezervat e nevojshme lidhur me autorizimin e akorduar nga autoritetet e larta në zbatueshmërinë e kontratës.

Objektivi i kontratës

Neni 3 përcakton objektivin e kontratës, duke iu referuar:

fushave të përcaktuara

zonave gjeografike

personave (komunave, organizmave kombëtare me kompetenca, vendore etj.)

formave juridike të përcaktuara.

Neni 4 vë si kusht kohëzgjatjen e kontratës, kushtet e vazhdimit dhe afatet e mundshme të realizimit.

Regjimi juridik dhe ekonomik i kontratës

Neni 5 përcakton vendin e nënshkrimit dhe të zbatimit të kontratës, saktëson regjimin juridik të kontratës (e drejta ndërkombëtare private) dhe të drejtën e zbatueshme.

Neni 6, ve si kusht, nëse ka vend, çështje të lidhura me regjimin monetar (monedhë me të cilën duhet të paguhet çmimi, si dhe mënyrën e rivlerësimit për pagesat me kohë të gjatë) dhe problemet e sigurimit.

Procedurat e arbitrazhit

Neni 7 parashikon nëse ka vend një procedurë koordinimi dhe parashikon një procedurë arbitrazhi.

Në këtë mundësi të fundit, komisioni i arbitrazhit përbëhet si më poshtë:

çdo Palë që ka një interes të kundërt zgjedh një person si anëtar të komisionit të arbitrazhit dhe Palët së bashku zgjedhin një ose dy anëtarë të pavarur në mënyrë që të arrijnë në një shifër tek anëtarësh.

në rast të numrit çift të anëtarëve të komisionit të arbitrazhit ose ndarjes së votave, vota e anëtarit të pavarur është përcaktuese.

Ndryshimi dhe shfuqizimi i kontratës

Neni 8 përcakton rregullat që zbatohen në rast të ndryshimit a të përfshirjes së kontratës.

Neni 9

Palët do të informojnë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës për përfundimin e kësaj marrëveshjeje dhe do t'i transmetojnë atij tekstin.

2.5. Skemë e kontratës së lëvrimit a kryerjes së shërbimeve ndërmjet kolektivave vendore kufitare (të llojit "e drejtë publike").

Shënim fillestar: Kjo kategori kontratash ngjason me atë që parashikohet në 2.4. (kontrata të

përfunduara me një qëllim të përcaktuar). Kjo kategori synon veçanërisht lëvrimin e shërbimeve publike ose punëve publike, qiradhënien e tokës dhe ofertat për ndihmë, të një komune ndaj një komune tjetër ose një organizimi tjetër nga ana e kufirit. Dhënia e pagesave të tilla me karakter publik përmban përgjegjësi dhe rreziqe të veçanta të lidhura me shërbimet publike, që kërkojnë për pasojë përfshirjen në kontratë të dispozitave të tjera përveç atyre të parashikuara për kontratën e tipit "e drejtë private".

Mundësia e "kalimit të kufirit" për këto lloj kontratash nuk është detyrimisht e pranueshme nga të gjitha vendet dhe nga ky fakt, një mundësi e tillë dhe përcaktimi i kushteve të ndihmës për kontrata të tilla, shpeshherë duhet të rregullohen paraprakisht në një marrëveshje ndërshtetërore (shiko modelin 1.4).

Nevoja për një kontratë të tillë, konceptimi dhe realizimi i së cilës janë të thjeshta, në disa raste mund të evitonte krijimin e një organizmi të përbashkët të tipit "Sindikatë interkomunale ndërkufitare (shiko 2.6) që shtron probleme të tjera juridike.

Dispozita kontraktuale për t'u parashikuar

Në rastin kur kontrata vë veprim, të paktën në njërin prej vendeve, rregullimin ose administrimin e fushës publike, të një shërbimi publik ose të një pune publike të një bashkësie vendore, është e nevojshme të parashikohen garanci kontraktuese konform rregullave në fuqi në vendin ose vendet përkatëse.

Nga ana tjetër, kontrata, sa të jetë e nevojshme, do t'i referohet kushteve të veçanta të mëposhtme:

1. rregullores që përcakton kushtet e rregullimit a funksionimit të punës ose shërbimit të vlerësuar (p.sh. orare, tarifa, kushte përdorimi etj).

2. kushteve të veçanta të vënies në njetë të sipërmarrjes ose shfrytëzimit, p.sh. lejet dhe autorizimet e domosdoshme, procedura etj.

3. fletores së ngarkesave të sipërmarrjes a shfrytëzimit;

4. procedurave të adaptimit të kontratës në proces zbatimi që rrjedhin nga kërkesat e interesit publik, si dhe kompensimeve financiare që dalin prej tyre;

5. modaliteteve të marrdhënieve që do të rrjedhin nga sipërmarrja ose shfrytëzimi i vlerësuar ndërmjet, nga njëra anë, përdoruesit e punës ose shërbimit dhe nga ana tjetër, shfrytëzuesi (p.sh. kushtet e pranimit, detyrimet etj);

6. modaliteteve të tërheqjes, riblerjes ose të denoncimit të kontratës.

Përveç këtyre kushteve të veçanta, zbatohen dispozitat e përmendura për skemën e kontratës 2.4.

2.6. Skemë e marrëveshjes për krijimin e organizmave të bashkëpunimit interkomunal ndërkufitar.

Shënim fillestar: Kuptohet se shumë autoritete vendore kanë pranuar të krijojnë së bashku një organizëm të pajisur me personalitet juridik me qëllim që të krijohet dhe shfrytëzohet një punë ose rregullim publik a shërbim publik.

Krijimi dhe funksionimi i kësaj shoqata ose kësaj sindikate do të varen kryesisht nga legjislacioni i zbatueshëm dhe saktësimet e domosdoshme që do të përmbajë një marrëveshje ndërshtetërore paraprake që autorizon këtë lloj bashkëpunimi (shiko modelin 1.5).

Këtu më poshtë është shënuar lista e dispozitave që statuset duhej të fiksonin, për aq sa ligji në fuqi nuk parashikon ato.

Statuset do të përcaktojnë veçanërisht:

1. Anëtarët themelues të shoqatës dhe kushtet e pranimit të anëtarëve të rinj;

2. Emrin, selinë, kohëzgjatjen dhe formën juridike të shoqatës (duke iu referuar ligjit që i takon si person juridik);

3. Objektin e shoqatës, kushtet e realizimit të këtij objekti dhe mjetet që ajo disponon.

4. Mënyrën se si është krijuar kapitali;

5. Rëndësinë e angazhimeve të bashkëpunëtorëve dhe limitet e tyre;

6. Mënyrën e emërimit dhe revokimit të administratorëve ose drejtuesve të shoqatës si dhe pushtetet e tyre;

7. Rosertet e shoqatës me anëtarët e saj, të tretët dhe autoritetet e larta, sidomos për sa i takon komunikimit të buxheteve, bilancet dhe llogaritë;

8. Personat, që janë ngarkuar për të ushtruar kontrollet teknike dhe financiare mbi aktivitetin e shoqatës dhe komunikimet e nevojshme për verifikimin e tyre;

9. Kushtet e ndryshimit të statuseve dhe të shpërbërjes së shoqatës;

10. Rregullat që zbatohen në fushën e personelit;

11. Rregullat që zbatohen në fushën e gjuhës.

PROTOKOLL SHTESË
I KONVENTËS-KUADËR ERUPIANE
MBI BASHKËPUNIMIN NDËRKUFITAR TË BASHKËSIVE VENDORE OSE AUTORITETEVE TERRITORIALE

Shtetet anëtarë të Këshillit të Europës, nënshkruese të këtij Protokolli shtesë të Konventës-Kuadër Europiane mbi bashkëpunimin ndërkufitar të bashkësive vendore e autoriteteve rajonale, e përmendur më poshtë me emrin "Konveta Kuadër";

Duke pohuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkufitar të bashkësive vendore dhe autoriteteve territoriale në rajonet kufitare;

Të vendosur për të marrë masa të reja, të domosdoshme për sigurimin e bashkëpunimit ndërkufitar të bashkësive vendore dhe autoriteteve territorirale;

Me dëshirën e mirë për të lehtësuar dhe zhvilluar bashkëpunimin ndërkufitar të bashkësive vendore ose autoriteteve territoriale të rajoneve kufitare;

Duke njohur nevojën e adoptimit të Konvetës Kuadër në realitetin Europian;

Duke konsideruar oportune plotësimin e Konventës Kuadër, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar midis bashkësive loakle dhe autoriteteve territoriale;

Duke iu referuar Kartës Europiane të Autonomisë Vendore;

Duke pasur parasysh Deklaratën e Komitetit të Ministrave mbi bashkëpunimin ndërkufitar në Europë me rastin e 40-vjetorit të Këshillit të Europës, që inkurajonte, ndër të tjera ndjekjen e veprimtarive me qëllim eleminimin progresiv të pengesave të çdo lloji, administrative, juridike, politike ose psikologjike, që mund të frenojnë zhvillimin e projekteve ndërkufitare;

Kanë arritur në dispozitat shtesë të mëposhtme:

Neni 1

1. Çdo palë kontraktuese, njeh dhe respekton të drejtën e bashkësive vendore ose autoriteteve territoriale nën juridiksionin e vet dhe duke pasur parasysh nenet 1 dhe 2 të Konventës Kuadër, të konkludojë në fushat e përbashkëta të kompetencave, marrëveshje të bashkëpunimit ndërkufitar me bashkësitë ose autoritetet territoriale të shteteve të tjera, sipas procedurave të parashikuara nga statutet e tyre, konform legjislacionit kombëtar dhe duke respektuar angazhimet ndërkombëtare të marra nga palët në fjalë.

2. Një marrëveshje për bashkëpunimin ndërkufitar angazhon vetëm përgjegjësitë e bashkësive vendore ose autoriteteve territoriale që e kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Neni 2

Vendimet e marra në kuadrin e një marrëveshjeje për bashkëpunimin ndërkufitar vihen në jetë nga bashkësitë ose autoritetet territoriale brenda kuadrit të tyre kombëtar ligjor, konform të drejtës së tyre kombëtare. Vendimet e vëna në jetë në këtë mënyrë si dhe efektet ligjore të tyre konsiderohen në të njëjtën vlerë juridike të marra nga këto bashkësi ose autoritete territoriale branda kuadrit të tyre juridik kombëtar.

Neni 3

Marrëveshjet për bashkëpunimin ndërkufitar të konkluduara nga bashkësitë ose autoritetet territoriale mund të krijojnë një organizëm të bashkëpunimit ndërkufitar me ose pa zotësi juridike. Marrëveshja do të tregojë, duke respektuar legjislacionin kombëtar, nëse ky organizëm, duke marrë parasysh detyrat që i janë atribuar, duhet konsideruar nën juridiksionin prej nga rrjedhin bashkësitë vendore ose autoritet territoriale, palë konkluduese të marrëveshjes, si një organizëm i së drejtës publike ose i së drejtës private.

Neni 4

1. Kur organizimi i bashkëpunimit ndërkufitar gëzon zotësi juridike, kjo është përcaktuar kështu nga ligji i palës kontratuese, në të cilën ajo e ka selinë.

Palët e tjera kontraktuese nga rrjedhin autoritet territoriale dhe bashkësitë e tilla palë në marrëveshje njohin zotësinë juridike të organizmit përkatës konform të drejtës së tyre të brendshme.

2. Organizmi i bashkëpunimit ndërkufitar ekzekuton misionet që i janë besuar nga bashkësitë vendore ose autoritetet territoriale konform obektit të vet dhe brenda kushteve të parashikuara nga e drejta e vendit nga rrjedh. Kështu:

a. aktet e organizmit të bashkëpunimit ndërkufitar, rregullohen nga statuti i tij dhe nga e drejta e vendit ku ai ka selinë;

b. megjithatë, organizmi i bashkëpunimit ndërkufitar nuk e ka zotësinë për të nxjerrë akte të karakterit gjithëpërfshirës ose akte që cënojnë të drejtat dhe liritë e personave:

c. organizmi i bashkëpunimit ndërkufitar financohet me pjesëmarrjen buxhetore të bashkësive vendore ose autoriteteve territoriale. Ky organizëm nuk ka asnjë të drejtë të kryejë veprimtari me natyrë fiskale. Ky organizëm, në rast nevoje mundet të marrë fatura për shërbime që ai i siguron bashkësive vendore e autoriteteve territoriale, përdoruesve ose të tretëve.

d. rganizmi i bashkëpunimit ndërkufitar përpunon një buxhet vjetor mbi bazën e parashikimeve dhe një llogari mbyllëse të vërtetuar nga ekspertë të pavarur të bashkësive vendore e autoriteteve territoriale, pjesëmarrës në marrëveshje.

Neni 5

1. Palët kontraktuese, në qoftë se legjislacioni i tyre i brendshëm i lejon, mund të vendosin që organizmi i bashkëpunimit ndërkufitar është një organizëm i të drejtës publike dhe që aktet e tij kanë brenda rregullit juridik të secilës palë kontraktuese të njëjtën vlerë juridike dhe efekte të njëjta sikur të ishin marrë nga bashkësitë vendore ose autoritetet territoriale që kanë konkluduar marrëveshjen.

2. Gjithësesi, marrëveshja mund të parashikojë që ekzekutimi i akteve është në përgjegjësinë e bashkësive ose autoriteteve territoriale që kanë bërë marrëveshjen. Veçanërisht nëse ato kanë prirje për të prekur të drejtat, liritë dhe interesat e individëve. Përveç kësaj, një palë kontraktuese mund të parashikojë që organizimi i bashkëpunimit ndërkufitar, të mos ketë të drejtën e një mandati të përgjithshëm dhe të mos ketë zotësinë për të marrë vendime e për të nxjerrë akte të karakterit gjithëpërfshirës.

Neni 6

1. Aktet e marra nga bashkësitë ose autoritetet territoriale, sipas një marrëveshjeje të bashkëpunimit ndërkufitar, i nënshtrohen kontrolleve të njëjta me ato të parashikuara nga e drejta e çdo pale kontraktuese mbi aktet e bashkësive ose autoriteteve territoriale që kanë bërë marrëveshjen.

2. Aktet e ndërmarra nga organizmat e bashkëpunimit ndërkufitar të kryera sipas një marrëveshjeje, i nënshtrohen kontrolleve të parashikuara nga e drejta e shtetit të vendodhjes së organizmit pa lënë pas dore interesat e bashkësive ose autoriteteve territoriale të shteteve të tjera.

Organizimi i bashkëpunimit ndërkufitar duhet të përmbushë kërkesat për informacion të dala nga autoritetet territoriale. Autoritetet e kontrollit të palëve kontraktuese kërkojnë mjetet e një koordinimi e të një informimi të përshtatshëm.

3. Aktet e ndërmarra nga organizmat e parashikuar në paragrafin 1 të nenit 5 i nënshtrohen kontrolleve të njëjtë me ato të parashikuara nga e drejta e çdo pale kontraktuese mbi aktet e bashkësive ose autoriteteve territoriale që kanë bërë marrëveshjen.

Neni 7

Mosmarrëveshjet e mundshme që rezultojnë nga funksionimi i organizmit të bashkëpunimit ndërkufitar çohen para juridiksionit kompetent sipas të drejtës kombëtare ose sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare.

Neni 8

1. Çdo palë kontraktuese, në momentin e firmosjes së këtij Protokolli ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit apo miratimit, tregon nëse i zbaton dispozitat e neneve 4 dhe 5 ose të njërit prej këtyre neneve.

2. Kjo deklaratë do të mund të modifikohet në çdo moment.

Neni 9

Nuk pranohet asnjë rezervë për dispozitat e këtij Protokolli.

Neni 10

1. Ky Protokoll është i hapur të firmoset nga shtetet që kanë firmosur Konventën- kuadër të cilat mund të shprehin pranimin e tyre për t'u lidhur me:

a. firmosje pa rezervë ratifikimi, pranimi ose aprovimi: ose

b. firmosje, me rezervë ratifikimi, pranimi ose aprovimi, e ndjekur nga ratifikimi, pranimi ose aprovimi.

2. Një shtet anëtar i Këshillit të Europës nuk mund ta firmosë këtë Protokoll pa rezervë ratifikimi, pranimi ose aprovimi ose të depozitojë një instrument ratifikimi, pranimi ose aprovimi nëse nuk ka depozituar tashmë njëkohësisht një instrument ratifikimi, pranimi ose aprovimi të Konventës - kuadër.

3. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose aprovimit do të depozitohen pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 11

1. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës kur katër shtetet, anëtare të Këshillit të Europës do të kenë shprehur miratimin e tyre për t'u lidhur me Protokollin, sipas dispozitave të nenit 10.

2. Për çdo shtet anëtar që do të shprehë më vonë aprovimin e tij për t'u lidhur me Protokollin, ky do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së firmosjes ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose aprovimit.

Neni 12

1. Pas hyrjes në fuqi të këtij Protokolli, çdo shtet që bën pjesë në Konventën - kuadër do të mund të aderojë gjithashtu në këtë Protokoll.

2. Aderimi do të kryhet pas depozitimit, pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës të një instrumenti i cili do të jetë i vlefshëm tre muaj pas datës së depozitimit të tij.

Neni 13

1. Çdo palë kontraktuese mund ta denoncojë këtë Protokoll që çdo moment duke i dërguar një njoftim Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Prishja do të jetë e vlefshme 6 muaj pas datës së marrjes së kallëzimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 14

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës i bën të ditur shteteve anëtare të Këshillit të Europës dhe çdo shteti që ka aderuar në këtë Protokoll:

a. të gjitha deklaratat e bëra të ditura nga një palë kontraktuese konform nenit 8.

b. Çdo firmë

c. Depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit.

d. Çdo datë të hyrjes në fuqi të këtij Protokolli, konform neneve 11 dhe 12.

e. Çdo akt tjetër, njoftim apo komunikim që lidhet me këtë Protokoll.

Përsa më sipër, nënshkruesit e autorizuar sipas normave për këtë çështje, e kanë firmosur këtë Protokoll.

Bërë në Strasburg më 9 Nëntor 1995 në frëngjisht dhe anglisht, të dy tekstet janë autentikë, në një kopje të vetme e cila do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të transmetojë kopje të saj të vërtetuara sipas secilit nga shtetet anëtare në Këshillit të Europës dhe çdo shteti të ftuar për të aderuar në këtë Protokoll.

PREAMBULA

Shtetet anëtare të KE nënshkrues të Protokollit në fjalë, nr.2 të Konventës Kuadër Europiane mbi Bashkëpunimin Ndërkufitar të Bashkisive vendore dhe Autoriteteve territoriale.

Duke patur parasysh mbledhjen e 9 Nëntorit 1995, të Protokollit shtesë të konventës kuadër, relative me efekte juridike të akteve të plotësuara në kuadrin e bashkëpunimit ndërkufitar dhe me statusin juridik të organizmave të bashkëpunimit të krijuara eventualisht, nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërkufituar;

Duke patur parasysh që për plotësimin sa më efikas të funksioneve të tyre, bashkësitë ose autoritetet territoriale, shpesh jo vetëm me bashkësitë fqinje të shteteve të tjera (bashkëpunimin interterritorial), por gjithashtu me bashkësitë e huaja jokufitare që paraqesin interesa të përbashkëta (bashkëpunimi interritorial) dhe kjo jo vetëm në kuadrin e orgnaizmave të bashkëpunimit ndërkufitar dhe shoqatave të bashkësive ose autoriteteve territoriale, por gjithashtu në planin bilateral;

Duke patur parasysh vullnetin e deklaratës së Vjenës së 1993, në të cilën, drejtuesit e shtetit ose Qeverisë së shteteve anëtare njohin rolin e Këshillit të Europës në krijimin e një Europe tolerante dhe të begatë nga këndvështrimi i bashkëpunimit ndërkufituar i bashkësive vendore dhe autoriteteve territoriale.

Duke patur parasysh që në fushën e bashkëpunimit interterritorial nuk ka ndonjë dokument të krahasueshme me Konventën Kuadër.

Duke shpresuar në krijimin e një kuadri juridik në planin ndërkombëtar për bashkëpunimin interterritorial, kanë rrjedhur këto dispozita:

Neni 1

Në kuptimin e këtij protokolli do të kuptojmë me bashkëpunimin interterritorial të gjitha lidhjet që tentojnë të shtrijnë roserte mes bashkësive ose autoriteteve territoriale mes dy ose me

shumë palësh kontraktuese, përveç roserteve të bashkëpunimit ndërkufitar të bashkësive fqinje, duke përfshirë aty konkluzionet e marrëveshjeve me bashkësitë vendore ose autoriteteve territoriale të shteteve të tjera.

Neni 2

1. Çdo palë kontraktuese njeh dhe respekton të drejtën e bashkësive ose autoriteteve territoriale duke ju referuar juridiksionit të vet dhe neneve 1 dhe 2 të Konventës Kuadër europiane mbi bashkëpunimin ndërkufitar të bashkësive dhe autoriteteve territoriale (që më poshtë do të emërtohet Koventë-Kuadër), për të mbajtur raporte dhe për të arritur konkluzione në fusha të përbashkëta të kompetencave të marrëveshjeve të bashkëpunimit interterritorial sipas procedurave të parashikuara nga statutet e tyre konform legjislacionit të brendshëm dhe duke respektuar angazhimet ndërkombëtare të marra nga palët kontraktuese në fjalë.

2. Një Marrëveshje bashkëpunimi ndërrajonale angazhon të vetmen përgjegjësi të bashkësive ose autoriteteve territoriale, të cilat e kanë bërë këtë Marrëveshje.

Neni 3

Palët kontraktuese në këtë Protokoll janë mutatis mutandis në Konventën Kuadër në bashkëpunimin ndërkufitar.

Neni 4

1. Palët kontraktuese në këtë protokoll që janë gjithashtu palë kontraktuese në protokollin shtesë në Konventën Kuadër e quajtur "protokoll shtesë" zbatojnë "mutatis mutandis", protokollin e lartëpërmendur në bashkëpunimin ndërterritorial.

Neni 5

Në kuptimin e këtij protokolli, shprehja (mutaltis mutandis) do të thotë që në konventën kuadër dhe në protokollin shtesë termi: "bashkëpunim ndërkufitar" duhet lexuar si "bashkëpunim ndërterritorial" dhe se nenet e konventës dhe të protokollit shtesë do të jenë të zbatueshme me përjashtim të rastit kur ky protokoll vendos ndryshe për këtë gjë.

Neni 6

1. Çdo palë kontraktuese në konventën kuadër dhe në protokollin shtesë në kohën e firmosjes së këtij protokolli ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, vë në dukje pranimin ose miratimin, në rast se ajo i zbaton, në përshtatje me dispozitat e nenit 4 të këtij protokolli me dispozitat e neneve 4 dhe 5 të protokollit shtesë ose vetëm të njerit të këtyre neneve.

2. Kjo deklaratë mund të rregullohet më vonë, në çdo kohë nëpërmjet një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 7

Asnjë rezervë nuk pranohet në dispozitat e këtij protokolli.

Neni 8

1. Ky protokoll është i hapur për t'u nënshkruar nga shtetet nënshkruese të konventës kuadër që mund të shprehin pëlqimin e tyre për t'u lidhur nëpërmjet:

a) nënshkrimit pa rezervë ratifikimi, pranimi ose miratimi,

b) nënshkrim me rezervë ratifikimi, pranimi ose miratimi ndjekur nga ratifikimi, pranimi ose miratimi.

2. Një shtet anëtar i Këshillit të Europës nuk mund ta nënshkruajë këtë protokoll pa rezervën e ratifikimit pranimin ose miratimin, ose të depozitojë një instrument ratifikimi, pranimi ose miratimi, në rast se ai nuk është depozituar që më parë ose në rast se ai nuk depoziton në të njëjtën kohë një instrument ratifikimi, pranimi ose miratimi të Konventës Kuadër.

3. Instrumentat e ratifikimit, pranimit ose miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 9

1. Ky protokoll do të hyjë në fuqi 3 muaj mbas datës në të cilën 4 shtete anëtare të Këshillit të Europës do të kenë shprehur pëlqimin e tyre për t'u lidhur nëpërmjet protokollit në përmbajtje me dispozitat e nenit 8. Ky protokoll do të hyjë në fuqi 3 muaj mbas datës së nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit të pranimit ose miratimit.

Neni 10

Mbas hyrjes në fuqi të këtij protokolli, çdo shtet që ka aderuar në Konventën-Kuadër do të mund të aderojë, gjithashtu, në këtë protokoll.

1. Aderimi do të bëhet nëpërmjet depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës të një instrumenti aderimi i cili do të ketë efekt 3 muaj mbas datës së depozitimit të tij.

Neni 11

1. Çdo palë kontraktuese mund që në çdo kohë t'i japë fund këtij protokolli, duke i dërguar një njoftim Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Heqja dorë do të ketë efekt 6 muaj mbas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 12

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'u njoftojë të gjitha shteteve anëtare të Këshillit të Europës dhe çdo shteti që ka aderuar në këtë protokoll:

a) të gjitha deklarimet e njoftuara nga një palë kontraktuese në përshtatje me nenin 6,

b) Çdo nënshkrim të këtij protokolli,

c) depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit,

d) Çdo datë të hyrjes në fuqi të këtij protokolli në përshtatje me nenin e tij 9 ose me nenin e tij., 10,

e) çdo akt tjetër njoftimi ose komunikimi që ka të bëjë me këtë protokoll.

Duke u bazuar në këtë dhe me autorizimin e nevojshëm për këtë qëllim, nënshkruesit kanë firmosur këtë protokoll.

Bërë në Strasburg, më _____ në anglisht dhe në frengjisht, duke qene të dy tekstet të njëvlefshëm, në një ekzemplar të vetëm, që do të depozitohet në arkivin e Këshillit të Europës.

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'i dërgojë nga kjo kopje të vërtetuar secilit nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe çdo shteti të ftuar për të aderuar në këtë protokoll.

ROSERT SHPJEGUES
HYRJE

1.Në 1963 Konferenca e Përhershme e Pushteteve Vendore dhe Rajonale të Europës miratoi Rezolutën 248, lidhur me bashkëpunimin ndërterritorial në të cilën, ajo i rekomandonte Komitetit të

Ministrave të hartonte një projektkonventë duke u nisur nga teksti që ajo kishte përpunuar dhe i kishte bashkëngjitur rezolutës së lartëpërmendur. Në Deklaratën e Vjenës të 9 tetorit 1993, shefat e shteteve dhe qeverive angazhonin Organizatën për të ndjekur punën e saj në fushën e bashkëpunimit ndërkufituar dhe për ta shtrirë atë në bashkëpunimin ndërmjet rajoneve ndërkufitare.

2.Komiteti i Ministrave, në vijim të rezulutës së (K.P.L.R.E) dhe të rekomandimeve të shefave të shteteve dhe të qeverive, kanë ngarkuar Komitetin Drejtues të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale (K.D.L.R) për të studiuar në dritën e projektit të konventës mbi bashkëpunimin ndërterritorial të përpunuar prej KPLRE, çështjen e kuadrit juridik të bashkëpunimit midis bashkësive vendore dhe rajonale jokufitare dhe, në rastin më të mirë të përgatisë një projektkonventë sipas shembullit të Konventës-Kuadër Europiane mbi bashkëpunimin ndërkufitar të bashkësive ose autoriteteve territoriale (STE nr.106)".

KDLR, nga ana e tij ja ka besuar këtë detyrë komitetit të tij të përbërë nga ekspertë mbi bashkëpunimin ndërkufitar (LR-R-RT).

1. Komiteti i kufizuar, mbas një shqyrtimi paraprak të çështjes ka përjashtuar mundësinë për të përgatitur një konventë të veçantë mbi bashkëpunimin ndërterritorial meqë problemi mund të trajtohej në mënyrë të efektshme në përshtatje me Konventën Kuadër Europiane mbi Bashkëpunimin Ndërkufitar të Bashkësive dhe Autoriteteve Territoriale (të quajtura më poshtë "konventa kuadër") dhe me protokollin e saj shtesë bashkëngjitur, të quajtur "protokolli shtesë" duke vlerësuar se problemet e ngritura në planin juridik ishin të natyrës së njëjtë. Komiteti i kufizuar ka vendosur të përqendrojë aktivitetin e tij, në mënyrë të veçantë në bashkëpunimin midis bashkësive territoriale duke përjashtuar aspektin lidhur me marrëdhëniet e

jashtme të këtyre bashkësive (p.sh., pjesëmarrje e këtyre në procesin e vendimit, në lidhje me tekstet ndërkombëtare (që u interesojnë atyre) ose paraqitja pranë organizatave ndërkombëtare).

Një aspekt i tillë nuk është në mënyrë strikte i palidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar.

1. Pas shqyrtimit të çështjes me qëllimin për të ditur nëse do t'i interesonte përpunimi i një rekomandimi ose i një protokolli Konventës Kuadër, komiteti i kufizuar është shprehur një favor të këtij instrumenti të fundit, për arsyet që vijojnë:

a) Statuti i Këshillit të Europës kërkon për miratimin e një rekomandimi, unanimitetin e zërave të shprehur dhe shumicën e përfaqësuesve që kanë të drejtën të kenë qëndrën në komitetin e ministrave. Përveç kësaj neni 15, paragrafi b i stututit i jep kompetencën komitetit të ministrave të ftojë shtetet anëtare për t'i bërë atij të njohur masat që ato kanë marrë në lidhje me rekomandimet.

Mirëpo duke e konsideruar së bashkëpunim ndërkufituar dhe bashkëpunimi ndërterritorial shtrojnë probleme të njëjta dhe kur mjaft shtete anëtare nuk e kanë nënshkruar akoma ose ratifikuar konventën kuadër, duket pak e mundshme se një rekomandim mbi çështjen do të mund të bëhej në unanimitet.

a) Protokolli shtesë paraqitet si një instrument fleksibël sepse me t'u hapur për nënshkrim ai nuk është i detyrueshëm përveç se për shtetet që do ta ratifikojnë. Asnjë detyrim juridik nuk ekziston për nënshkrimin dhe ratifikimin, ndërsa rekomandimet u drejtohen gjitha shteteve anëtare. Kështu, një protokoll shtesë përbën në të njëjtën kohë një instrument fleksibël dhe dinamik, sepse ai angazhon shtetet që e ratifikojnë atë menjëherë duke u lejuar atyre kështu të fitojnë një eksperiencë të çmuar që do të mundte të ishte e nevojshme më vonë për shtetet që aderojnë atje.

1. Kështu që mbi bazën e punës së komitetit të kufizuar dhe të propozimeve të KDLR, Komiteti i Ministrave ka vendosur të pranojë dhe të hapë për nënshkrim protokollin nr.2 në Konventën Kuadër.

KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

1. Konventa kuadër dhe protokolli i saj shtesë kanë të bëjnë me marrëdhëniet midis bashkësive jokufitare, domethënë të bashkësive territoriale të cilat qoftë drejtpërdrejt (nëpërmjet një kufiri të përbashkët), qoftë indirekt (nëpërmjet bashkësisë në një grup bashkësisht territoriale që përbëjnë një grup të ndarë nga kufij të përbashkët), janë gjeografikisht fqinjë.

2. Ndërkaq dinamizimi i marrdhënieve ndërmjet bashkësive territoriale përtej kufirit

nacional ka qenë i tillë që disa marrëveshje janë mbyllur midis disa entiteteve gjeografikisht të largëta. Shembuj të tillë të marrëveshjes rajonale ekzistojnë midis Spanjës, Francës, Italisë dhe Belgjikës që kanë krijuar pole të zhvillimit ekonomik të përparuara nga ana teknologjike. Mjaft marrëveshje binjakëzimi ndërmjet qytetesh ose ndërmjet rajonesh janë në realitet marrëveshje bashkëpunimi të përparuara që trajtojnë çështje tradicionale me përjashtim të marrëveshjeve të binjakëzimit klasik. Mirëpo duhet parashikuar se këto tipe kontaktesh ndërmjet bashkësive territoriale do të zhvillohen në mënyrë të konsiderueshme në të ardhmen.

3. Çështja që shtrohet është si rrjedhim të dihet nëse këto nisma duhet të ndiqen jashtë çdo kuadri juridik në nivel ndërkombëtar ose më mirë, nëse është e përshtatshme që të regjistrohen që në fillim në një kuadër mjaft të njohur dhe të provuar.

4. Teknika juridike që është zgjedhur për përpunimin e protokollit nr.2 konsiston për të ndërmarrë bashkëpunimin ndërkombëtar duke ju referuar dy instrumenteve juridike ekzistues në lidhje me bashkëpunimin ndërkufitar për të ditur konventën kuadër dhe protokollin e saj shtesë.

KOMENTE MBI NENET

Neni 1

1. Ky nen përcakton "bashkëpunimin ndërkufitar" duke përdorur një kriter, për të thënë kështu negativ. Është i konsiderueshëm në fakt bashkëpunim ndërterritorial, çdo qëndrim ndërmjet bashkësive territoriale që nuk është i cilësuar si ndërkufituar ndërmjet konventës kuadër dhe protokollit të saj shtesë.

2. Një përcaktim i tillë mund të krijojë vështirësi interpretimi në disa raste anësore, por do të duhej lehtësisht të lejonte për t'i rregulluar ato në rast se e konsideron se aspekti kryesor i bashkëpunimit ndërterritorial është mungesa e vazhdimësisë territoriale ndërmjet bashkësive ose grupeve të bashkësive.

Neni 2

1. Ky nen rinjeh parimin e të drejtës së bashkësive ose autoriteteve territoriale për të bërë marrëveshje midis tyre në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Shtetet janë të detyruara të rinjohin dhe respektojnë këtë të drejtë që ushtrohet në kushtet dhe limitet e përcaktuara nga Konventa Kuadër, protokolli i tij shtesë dhe ky protokoll.

2. Kështu psh ja vlen të kujtojmë se në përshtatje me këtë nen marrëveshjet e bashkëpunimit ndërterritorial duhet të mbyllen:

a) Në kuadrin e kompetencave të bashkësive të autoriteteve territoriale, të cilat janë të lidhura nga ato,

b) Sipas procedurës së parashikuar nga statutet e bashkësive ose autoriteteve territoriale,

c) Mbi bazën e respektimit të angazhimeve ndërkombëtare të shteteve ose autoriteteve territoriale që u përkasin.

d) në përshtatje me legjislacionin kombëtar të çdo shteti në lidhje me tatimin e organizmave të bashkëpunimit ndërkombëtar

1. Një kërkesë e rëndësishme imponohet nëpërmjet shprehjes "fusha të përbashkëta kompetencash". Kjo shprehje tregon se për të bërë një marrëveshje të gjitha bashkësitë ose autoritetet territoriale përkatëse, duhet të kenë kompetenca në çështjen që është objekti i marrëveshjes. Kjo do t ë thotë që, nëse një kompetencë e tillë nuk është e përshirë por e deleguar ose e ndarë, bashkësia ose autoriteti territorial në çështje do të duhet t'u binden të gjitha kërkesave të legjislacionit kombëtar që rregullon një çështje të tillë.

2. Shprehja "në përshtatje me legjislacionin kombëtar" tregon se bashkësitë ose autoritetet territoriale duhet të respektojnë procedurat dhe rregullat e tjera të parashikuara nga legjislacioni kombëtar i shtetit të cilit i përket gjatë kohës së bërjes dhe ekzekutimit të marrëveshjeve të tyre. Lidhja me shprehjen "fusha të përbashkëta kompetencash" tregon se bashkësitë ose autoritetet

territoriale nuk mund që me rastin e mbylljes së një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërterritorial, të marrin kompetencat të cilat nuk janë të njohura për to nga e drejta kombëtare, as të krijojnë një kategori të re autoritetesh vendore.

3. Neni nuk trajton ndërveprime midis marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërterritorial dhe angazhimeve ndërkombëtare të përfunduara më vonë nga palët kontraktuese.

4. Paragrafi 2 tregon qartë se asnjë përgjegjësi e shtetit ose e çdo autoriteti ose bashkësie tjetër jonënshkruese të marrëveshjes, nuk mund të angazhohen gjatë përfundimin ose vënies në jetë të një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërkombëtar ndërmjet bashkësive ose autoriteteve territoriale.

Neni 3 dhe 4

18. Këto nene kanë të bëjnë me regullimin kryesor të bashkëpunimit territorial. Ky rregullim është i siguruar ndërmjet referimit në përmbajtje të instrumenteve të tjerë ndërkombëtare të zbatueshëm, domethënë konventa kuadër dhe protokolli i saj shtesë.

19. Megjithatë, meqënëse ndërmjet bashkëpunimit ndërterritorial dhe bashkëpunimit ndërkufitar mund të ekzistojnë dallime, nenet 3 dhe 4, atëherë kur është fjala për konventën kuadër dhe protokollin e saj shtesë, tregojnë se këto instrumente duhet të zbatohen "mutatis mutandis".

20. Rezulton se saktësimet e bëra përsa i përket interpretimit të Konventës Kuadër dhe protokollit të saj shtesë në marrëdhëniet e tyre shpjeguese respektive, janë gjithashtu të vlefshme në këtë protokoll, në masën ku dispozitat e dy instrumenteve të lartëpërmendura janë të zbatueshme për bashkëpunimin ndërterritorial.

Neni 5

21. Megjithëse shprehja "mutatis mutandis" është mjaft e njohur dhe e përdorur shpesh në instrumentet juridike dhe ndërkombëtare, është vlerësuar e nevojshme që për atë të jepet një përcaktim me qëllim për zbatimin e këtij protokolli.

22. Në përshtatje me këtë përcaktim, dispozitat e Konventës Kuadër dhe të protokollit të saj shtesë zbatohen në bashkëpunimin ndërkombëtar, pra do të korigjohen me shkrim duke zevendësuar shprehjen "bashkëpunim ndërkufitar" me "bashkëpunim ndërterritorial".

Neni 6

23. Arsyeja e ekzistencës së këtij neni është se, në bazë të nenit 3 të protokollit shtesë në marrëveshje bashkëpunimi ndërkufitar e përfunduar nga bashkësi ose autoritete territoriale, mund të çojë në krijimin e një organizimi dhe bashkëpunimi ndërkufitar i cili do të mund të varet nga një regjim i të drejtës private ose së drejtës publike. Neni 8 i protokollit shtesë parashikon që çdo palë kontraktuese bën të ditur në qoftë se ajo zbaton dispozitat e neneve 4 dhe 5 ose të njërit prej këtyre neneve. Neni 4 i protokollit shtesë parashikon rastin kur një organizëm bashkëpunimi ndërkufitar është i përbërë nga personalitete juridike. Neni 5 trajton shprehimisht masat e marra nga organizimi i bashkëpunimit që palët kontraktuese vlerësojnë se është një entitet i të drejtës publike.

24. Duke konsideruar se palët kontraktuese për vënien në jetë të këtij protokolli, mund të adaptojnë një zgjidhje të ndryshme nga ajo e bërë për vënien në jetë të protokollit shtesë, p.sh duke zbatuar një regjim të të drejtës publike për një organizëm të bashkëpunimit ndërkufitar dhe një regjim të së drejtës private për një organizëm të bashkëpunimit ndërterritorial, ato të detyruara të bëjnë të ditur nëse do të zbatojnë dispozitat e neneve 4 dhe 5 të protokollit shtesë ose ato të njërit prej këtyre neneve.

Neni 9 dhe 14

25. Dispozitat përfundimtare që janë objekt i neneve 9 dhe 14, janë në përgjithësi në përshtatje me modelin e klauzolave përfundimtare për instrumentet konvencionale të përpunuara në gjirin e Këshillit të Europës.

V E N D I M
Nr.641, datë 30.11.2000

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.335, DATË 2.9.1997, "PËR PAJISJEN ME PASAPORTË SHËRBIMI DHE DIPLOMATIKE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në fund të pikës 4, të vendimit nr.335, datë 2.9.1997, të Këshillit të Ministrave, shtohet fjalia si vijon:

"Nënkryetarët e Këshillit Kombëtar të Punës.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.645, datë 5.12.2000

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.531, DATË 5.10.2000, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KUOTËN E PRANIMIT NË AKADEMINË E POLICISË, NË VITIN SHKOLLOR 2000-2001, NË SISTEMIN ME SHKËPUTJE NGA PUNA"

Në mbështjetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 31, të ligjit nr.8641, datë 25.2.1999, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Shkronja "c", e pikës 2, të vendimit nr.531, datë 5.10.2000, të Këshillit të Ministrave ndryshohet si vijon:

"Kuota për ministrin e Rendit Publik.....12"

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.652, datë 5.12.2000

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.224, DATË 15.5.1995, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT KONSULTATIV TË AVIACIONIT CIVIL"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8, të ligjit nr.7877, datë 31.11.1994, "Për aviacionin civil shqiptar", me propozimin e ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.224, datë 15.5.1995, të Këshillit të Ministrave bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, paragrafi i dytë, ndryshohet si vijon:

"Këshilli Konsultativ i Aviacionit Civil ka përbërjen e mëposhtme:

- Ministri i Transportit kryetar
- Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit anëtar
- Ministri i Mbrojtjes anëtar
- Ministri i Rendit Publik anëtar
- Ministri i Financave anëtar
- Ministri i Drejtësisë anëtar
- Ministri i Pushtetit Lokal anëtar
- Kryetari i Komitetit të Turizmit anëtar
- Drejtori i Përgjithshëm i aviacionit civil sekretar.".

2. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

"Kur ministri, për arsye objektive, nuk mund të marrë pjesë në mbledhje, ai delegon zëvendësministrin.

Në raste të veçanta, me miratimin e kryetarit, në mbledhjen e Këshillit Konsultativ marrin pjesë specialistë të ndryshëm, sipas problemeve që do të trajtohen."

3. Në pikën 6 fjalët "industrisë" dhe "dhe tregtisë", shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Fletorja Zyrtare gjendet në:

1. Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
2. Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 16.12.2000
Doli nga shtypi më 16.12.2000

Tirazhi: 3700 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e "Tipografisë Ushtarake"

Çmimi: 100 lekë